Paneli këshillëdhënës për të drejtat e njeriut
Building D, UNMIK HQ, Prishtinë/Kosovë | E-mail: hrap-unmik@un.org | Tel: +381 (0)38 504-604, ext. 5182

MENDIM

Data e miratimit: 18 maj 2016

Lënda nr. 81/10

Punëtorët e minierave Kishnicë dhe Novobërdë të Kombinatit Trepça

kundër

UNMIK-ut

Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut, i mbledhur më 18 maj 2016,
me pjesëmarrjen e këtyre anëtarëve:

Marek Nowicki, kryesues
Christine Chinkin
Françoise Tulkens

Të ndihmuar nga

Andrey Antonov, zyrtar ekzekutiv

Pasi mori parasysh ankesën e lartpërmendur, e parashtruar në pajtim me nenin 1.2 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12, të datës 23 mars 2006, mbi themelimin e Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut,

Pas shqyrtimit të vëmendshëm, vendosi si në vijim:

I. PROCEDURAT PARA PANELIT

1. Ankesa është paraqitur më 18 mars 2010 dhe është regjistruar më 21 shtator 2010. Në momentin e dorëzimit të saj, ankesa është konsideruar të jetë dorëzuar nga 667 punëtorë të minierave Kishnicë dhe Novobërdë, të përfaqësuar nga njëri nga ta, z. Momqillo Nedelkoviq.

2. Më 14 prill 2014, Paneli e shpalli ankesën të pranueshme pjesërisht. Për sa i përket historisë së plotë të procedurave, Paneli i referohet këtij vendimi mbi pranueshmërinë (§§ 1-18)[1].

[1] Të gjitha tekstet janë në dispozicion në faqen e internetit të Panelit: www.unmikonline.org/hrap/Eng/Pages/default.aspx

3. Më 15 prill 2014, Paneli ia përcolli këtë vendim mbi pranueshmërinë PSSP-së, duke kërkuar komentet e UNMIK-ut lidhur me bazueshmërinë e ankesës.

4. Më 10 qershor 2014, PSSP-ja paraqiti përgjigjen e UNMIK-ut në lidhje me bazueshmërinë e ankesës.

5. Më 18 nëntor 2015, Paneli kërkoi qartësim nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme mbi çështjet që ndërlidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS).

6. Me anën e një letre të datës 9 dhjetor 2015, e cila është pranuar nga Paneli më 24 dhjetor 2015, DHPGJS i ofroi informata shtesë Panelit.

7. Me 29 dhjetor 2015, Paneli informoi PSSP-në për përgjigjen e mësipërme të DHPGJS-së dhe e ftoi atë të ofrojë komente shtesë në lidhje me këtë.

8. Më 9 shkurt 2016, Paneli pranoi komente shtesë nga UNMIK-u.

9. Në periudhën mes 25 prillit dhe 13 majit të vitit 2016, Sekretariati i Panelit mori një numër dokumentesh shtesë dhe mbajti takime me Administratën e Trepçës, Ministrinë e Kosovës për Punë dhe Mirëqenie Sociale (MPMS), Zyrën e këshilltarit ligjor të UNMIK-ut (ZKL), si dhe përfaqësuesin e ankuesit.

II. FAKTET

A. Kompleksi i minierave Trepça nën administrim të UNMIK-ut

10. Ankuesit janë punëtorë të Ndërmarrjes Shoqërore "Minierat me Flotacion Kishnica dhe Novobërda, Prishtinë" (Minierat e Kishnicës). Minierat e Kishnicës përbëjnë një pjesë të "Kombinatit Xehetaro Metalurgjik Kimik të Plumbit dhe Zinkut Trepça", në tekstin e mëtejmë – Kombinati Trepça).

11. Kombinati Trepça ishte njëri nga ndërmarrjet më të mëdha shoqërore (NPSH) në ish-Jugosllavi i cili, gjatë zenitit të vet në 1970-a dhe 1980-a, punësoi mijëra punëtorë. Siç raportohet, në vitin 2003 Organizata Ndërkombëtare për Migrim (IOM) regjistroi 9445 punëtorë të Kombinatit Trepça, nga të cilët 3908 ishin serbë të Kosovës dhe 5537 shqiptarë të Kosovës[2]. Në vitin 2006, 9400 punëtorë (6,500 shqiptarë të Kosovës dhe 3,900 serbë të Kosovës) ishin akoma të regjistruar[3].

12. Me vendosjen e Kosovës nën administrim të UNMIK-ut në pajtim me Rezolutën e Këshillit të Sigurimit të OKB-së 1244 (1999) të 10 qershorit 1999 dhe Rregulloren e UNMIK-ut nr. 1999/1 *mbi Autoritetin e UNMIK-ut në Kosovë*, UNMIK-u u bë përgjegjës për administrimin e *përkohshëm* të të gjitha ndërmarrjeve shoqërore dhe publike, duke përfshirë Kombinatin Trepça.

---

[2] Shih: *Nelles P*. Qëllimi i Trepçës. Nëntor 2003, f. 12 // Në dispozicion në [burimi elektronik] - http://www.esiweb.org/pdf/esi_mitrovica_trepca_id_1.pdf (qasur më 12 maj 2016).

[3] Shih: Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP), Raport vjetor janar-dhjetor 2010, f. 17 // Në dispozicion në faqen e internetit të AKP-së [burimi elektronik] - http://www.pak-ks.org/repository/docs/raporti_anglisht_FINAL.pdf (qasur më 12 maj 2016).

13. Me arritjen e tij në Kosovë, për arsye ambientale dhe të shëndetit publik dhe ristrukturimit në pritje të Kombinatit Trepça, UNMIK-u me përkrahjen e KFOR-it pjesërisht mbylli punën në Kombinatin Trepça, e cila *de facto* e bëri një pjesë të fuqisë së tij punëtore të tepërt. Duke filluar nga 13 qershori i vitit 2002, Kombinati Trepça, si NSH, është vendosur nën administrimin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit (KTA), të themeluar me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2002/12, me mandat që t'i administrojë ndërmarrjet shoqërore dhe publike dhe asetet e tyre përkatëse si administrator, në interes të pronarëve të tyre.

14. Sipas informatave që Zyra e IOM-it në Kosovë ia ofroi Panelit, në periudhën 2001-2002, me kërkesën e UNMIK-ut që të ndihmojë në "ritrajnimin dhe shkurtimin" e ish-fuqisë punëtore dhe fuqisë aktuale punëtore të Kombinatit Trepça, IOM-i bëri regjistrimin dhe profilizimin demografik dhe profesional të punëtorëve të Kombinatit Trepça, duke përfshirë Minierat e Kishnicës. Në fillim të vitit 2002, si formë të shkurtimit, IOM-i propozoi dhe ndihmoi në krijimin e një skeme të re pensionimi, të cilës zgjodhën t'i bashkohen punëtorët që kishin arritur një moshë përkatëse dhe të cilët i plotësonin kriteret e tjera. Punëtorët të cilët zgjodhën këtë skemë të re pensionimi u larguan nga lista e pagave të Kombinatit Trepça, dhe kështu lehtësuan barrën financiare të ndërmarrjes.

15. Në vitin 2003 MPMS-ja e Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes (IPVQ) të Kosovës (strukturat qeveritare nën autoritetin e përgjithshëm të UNMIK-ut) nxori Udhëzimin Administrativ nr. 3/2003 *mbi Pensionimin e Parakohshëm për Punëtorët e Trepçës nën administrim të UNMIK-ut*, i cili hyri në fuqi më 1 korrik 2003. Ky udhëzim vendosi kushtet për regjistrim në skemën e re të pensionimit (p.sh. të qenit 50 deri 65 vjeç, të ketë punuar së paku 10 vjet në ndërmarrje dhe ta ketë ndërprerë punësimin në ndërmarrje), e që do të financohet nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës (BKK) i kontrolluar nga UNMIK-u. Në pajtim me këtë udhëzim, pagesa e pensioneve të parakohshme, të nisura në shumën fillestare prej 40 eurosh në muaj, ishte vendosur të fillojë më 1 korrik 2004. Ky program parashihte që përfituesit të cilët kanë arritur moshën e rregullt për pensionim do të largoheshin nga skema e pensionimit të parakohshëm dhe në vend të kësaj do të fillonin të përfitonin nga sistemi pensional i Kosovës.

16. Përveç kësaj, një sistem i "pagesave" për ata që nuk ishin të kualifikuar, apo nuk kishin pasur një pensionim të parakohshëm ishte krijuar, me sa duket nga UNMIK-u në bashkëpunim me menaxhmentin e Kombinatit Trepça. Është raportuar në nëntor të vitit 2003 nga ish-atëherë "Menaxheri i Trepçës" i emëruar nga UNMIK-ut, por vetëm në lidhje me "mbylljen me forcë të Shkritores së Plumbit në Zveçan", se ndërmarrja mbajti në listë të pagave "pak më shumë se 2000 persona me rrogë (1000 shqiptarë, 1000 serbë) dhe deri në 2300 serbë për pagesa"[4].

17. Sipas informatave të mbledhura nga Paneli, falë kësaj marrëveshje të negociuar nga UNMIK-u me përfshirjen e sindikatave të punëtorëve dhe Administratës së Trepçës (të të dyjave në jug dhe në veri), ata punëtorë joaktivë të të gjitha minierave të Trepçës, të cilët nuk i plotësonin kushtet për pensionim të parakohshëm apo të rregullt, apo të cilët zgjodhën të mos kenë pensionim të parakohshëm dhe ishin duke pritur të kthehen në punë sapo ndërmarrja të rifillojë punën, u ishte ofruar një pagesë mujore prej 50 eurosh. Kjo përfshinte 30 euro nga vetë burimet e Trepçës dhe 20 euro nga BKK-ja. Sipas Raportit të Auditimit të vitit 2012 të Zyrës së Auditorit Gjeneral në Kosovë, prej vitit 2010,

[4] Shih raportin e përmendur më lart *Qëllimi i Trepçës* (fusnota nr. 2), në f. 12.

punëtorët/të paguarit nën Administratën e Kombinatit Trepça në veri (kryesisht serbë të Kosovës) ndërprenë pranimin e pjesës së ndihmës mujore që vinte nga BKK-ja[5].

18. Siç konfirmohet nga shifrat në dispozicion publik, jo të gjithë punëtorët joaktivë (por jo të pensionuar) merrnin një pagesë mujore. Për shembull, në Raportin vjetor të vitit 2010 të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP), thuhet se në vitin 2006 vetëm 3,400 punëtorë të regjistruar të Kombinatit Trepça prej 9,400 (6,500 shqiptarë të Kosovës dhe 3,900 serbë të Kosovës) merrnin pensione të parakohshme dhe 2,300 merrnin pagesa[6].

19. Pavarësisht nga të gjitha përpjekjet, Paneli nuk ishte në gjendje të marrë një konfirmim nga ndonjë autoritet lokal apo UNMIK-u, nëse shifrat e mësipërme përfshinin punëtorët e Minierave të Kishnicës. Paneli është informuar se secila administratë, në veri dhe në jug, mbante një listë të veçantë të punëtorëve "të tyre" të cilët marrin këto pagesa mujore. Paneli është informuar se lista e personave të tillë e mbajtur nga Administrata e Trepçës në jug nuk përfshin minatorët e Kishnicës. Sipas raportit të lartpërmendur të auditimit për vitin 2012, deri në fund të vitit 2012 kishte 199 persona që merrnin pagesa në listën "e jugut"[7]. Në raportin e njëjtë të auditimit thuhet se për sa i përket Administratës së Trepçës në veri se "[l]ista e pranuesve të pagesave në vitin 2012 përmbante përafërsisht 1,883 persona dhe shpenzimet për vitin 2012 ishin në shumën prej €675,120."[8]

20. Për më tepër, pavarësisht kërkimit të të dhënave në disa institucione dhe bashkëbisedues në Kosovë (menaxhmenti i Trepçës, të dyja në veri dhe në jug, ZKL të UNMIK-ut, MPMS-ja e Kosovës), Paneli nuk mundi të gjente ndonjë pjesë legjislacioni, rregulloreje apo vendimi të qeverisë të publikuar që përmbledh kriteret e kualifikueshmërisë dhe mekanizmin rregullator për pranimin e këtyre "pagesave".

21. Përshtypja e Panelit se një dokument i tillë nuk ekziston vërtetohet nga Raporti i Auditimit për vitin 2012 në Kombinatin Trepça, në të cilin thuhet në pjesën në lidhje me Administratën në jug se "nuk posedonte këtë vendim dhe nuk kishte asnjë rregullore që përcaktonte kriteret dhe kushtet për përzgjedhjen e përfituesve"[9]. Në lidhje me Administratën në veri në të shtohet se:

> "Nuk kishte asnjë rregullore se si të trajtohen dhe menaxhohen pagesat, ndërsa dosjet e pranuesve të pagesave nuk ishin të plota. Vetëm një fletore e punës e punëtorëve të vjetër ishte e bashkangjitur në këto dosje, ndërsa dokumentet e reja mungonin, duke përfshirë letërnjoftimin, një kopje të llogarisë bankare si dhe kontrata e punësimit për kohën kur këta marrës të pagesave ishin punësuar."[10]

22. Më 2 qershor 2005, PSSP-ja nxori Udhëzimin Administrativ nr. 2005/7 *për Implementimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2002/13 mbi Themelimin e një Dhome të Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që ndërlidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit*. Ky udhëzim pezulloi të gjitha veprimet e caktuara "të drejtuara kundër apo në lidhje me asetet apo ndërmarrjet që janë nën autoritetin administrativ dhe

---

[5] Shih: Raportin e Auditorit Gjeneral të Kosovës (AGJKG) *mbi pasqyrat financiare të Ndërmarrjes Shoqërore Trepça për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2012*, qershor 2013, Neni 7.2.4, p. 47 // Në dispozicoin në faqen e internetit të ZAGJ-së [burimi elektronik] - http://www.oag-rks.org/repository/docs/RaportiAuditimit_Trepca_2012_ang_197200.pdf (qasur më 12 maj 2016).
[6] Shih: fusnota nr. 3 më lart.
[7] Shih: Raportin e lartpërmendur të Auditimit, Neni 6.2.5, f. 28.
[8] Shih: *ibid*., Neni 6.2.5, f. 28.
[9] Shih: *ibid*., Neni 7.2.4, f. 47.
[10] Shih: *ibid*., Neni 6.2.5, f. 28.

menaxhimin e [AKP-së] dhe të caktuara si pjesë e Trepçës nën Administratën e UNMIK-ut, duke u bazuar në vendime gjyqi, gjykime apo vendime tjera të lëshuara nga ndonjë gjykatë, organ kuazi-gjyqësor apo administrativ, për një periudhë prej tre muajsh. [PSSP-ja] mund të zgjasë këtë pezullim të periudhës zbatuese me një instrument pasues legjislativ". Neni 3.2(iii) i këtij Udhëzimi përmend Minierat e Kishnicës në mesin e aseteve të Kombinatit Trepça.

23. Më 21 nëntor 2005, Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2005/48 *mbi Riorganizimin dhe Likuidimin e Ndërmarrjeve dhe Aseteve të Tyre nën Autoritetin Administrativ të Agjencisë Kosovare të Privatizimit*, ofroi dispozitat për riorganizimin apo likuidimin e NSH-ve josolvente, sikur Kombinati Trepça, përmes "procedurave të moratoriumit". Me qëllim të mbrojtjes së ndërmarrjeve në fjalë nga pretendimet e kreditorëve gjatë ristrukturimit apo likuidimit të tyre, Rregullorja parashihte që, me anën e një kërkese të justifikuar të AKM-së, DHPGJS mund të marrë një "vendim për moratorium" (Vendimi për moratorium) duke suspenduar "të gjitha veprimet, procedurat apo aktet e çfarëdo lloji që kanë për qëllim zbatimin apo përmbushjen e ndonjë pretendimi kundër ndërmarrjes në fjalë apo aseteve të saj", i cili mund të vazhdohet me lejen e DHPGJS-së. Rregullorja, po ashtu, parashihte marrjen e një sërë masave drejt riorganizimit të një ndërmarrje, sikur emërimi i një apo më shumë administratori (ëve) të pavarur jo më vonë se tre muaj pas lëshimit të një vendimi për moratorium (Neni 8) dhe elaborimin e planeve ristrukturuese për t'u diskutuar dhe votuar nga kreditorët dhe më pas përkrahja nga Dhoma e Posaçme (Neni 27).

24. Më 15 dhjetor 2005, AKM-ja paraqiti një kërkesë në DHPGJS, përmes së cilës kërkoi lëshimin e një vendimi për moratorium në lidhje me Kombinatin Trepça dhe të gjitha asetet e tij.

25. Më 9 mars 2006, DHPGJS nxori vendim mbi moratoriumin nr. SCR-05-001, të kërkuar nga AKM-ja. Në tekstin e tij thuhet, *inter alia*, që "Prej datës së këtij vendimi mbi moratoriumin të gjitha veprimet, procedurat apo aktet e çfarëdo lloji me qëllim zbatimin apo përmbushjen e ndonjë pretendimi kundër Trepçës nën administrim të AKM-së siç është përkufizuar më lart, apo aseteve të saj duhet të suspendohen dhe do të vazhdojnë vetëm me lejen e kësaj Gjykate në pajtim me nenin 5.2 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2005/48."

26. Në paragrafin e fundit të Moratoriumit thuhet:

> "Gjykata pret se AKM-ja do të procedojë shpejt me marrjen e propozimeve për administratorët dhe ofruesit e shërbimit dhe të bëjë regjistrimin e pasurisë siç kërkohet me Rregulloren e UNMIK-ut 2005/48. <u>Nëse ka vonesa të tepërta, secila palë e dëmtuar mund të kërkojë nga kjo gjykatë heqjen e këtij moratoriumi</u> [është vënë theksi]."

27. Më 28 dhe 29 mars 2006, informata rreth vendimit mbi moratoriumin është publikuar në një gazetë ditore me seli në Kosovë *Koha Ditore*. Publikimi nuk përfshinte tekstin e plotë të moratoriumit, vetëm paraqiste substancën e vendimit. Ai u ofroi të gjithë kreditorëve dhe palëve tjera të interesuara udhëzime të detajuara se si t'i dorëzojnë ankesat e tyre në AKM. Ky publikim nuk pasqyroi pikën e mësipërme të përmendur në lidhje me mundësinë për palët e dëmtuara të kërkojnë nga DHPGJS të heqë moratoriumin.

28. Pas shpalljes së njëanshme të pavarësisë së Kosovës, më 17 shkurt 2008 dhe hyrjes në fuqi të Kushtetutës së Kosovës më 15 qershor 2008, UNMIK-u nuk ishte më në gjendje të kryejë efektivisht pjesën më të madhe të detyrave të veta si një administratë e përkohshme, dhe PSSP-ja nuk ishte në gjendje të zbatojë autoritetin ekzekutiv që akoma formalisht i ishte dhënë atij sipas Rezolutës së Këshillit të Sigurimit 1244 (1999) (shih, p.sh., Raport i Sekretarit të Përgjithshëm për Misionin e Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, 12 qershor 2008, S/2008/354, §§ 7 dhe 17; *Raport i Sekretarit të Përgjithshëm për Misionin e Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë*, 15 korrik 2008, S/2008/458, §§ 3-4 dhe 29; *Raport i Sekretarit të Përgjithshëm për Misionin e Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë*, 24 nëntor 2008, S/2008/692, § 21).

29. Prej muajit maj të vitit 2008, administrimi i Kombinatit Trepça dhe të gjitha aseteve të tij ishte marrë përsipër nga atëherë e sapoformuara AKP, duke vepruar nën autoritetet lokale të Kosovës. Pas 15 qershorit të vitit 2008, AKM-ja, si organ i UNMIK-ut, ndërpreu punën e vet. Më 24 gusht 2008, ish-zyrtarët lokalë të AKM-së, të emëruar nga autoritetet e Kosovës në pozita zyrtare në AKP, morën përsipër Kompleksin e AKM-së. Pas marrjes përsipër të kompleksit**,** është pritur që AKP-ja të bënte përpjekje të rifillojë procesin e privatizimit (shih Raportin e SP të OKB-së nr. S/2008/692, përmendur në § 28 më lart).

30. Megjithatë, origjinalet e dokumenteve në lidhje me përfshirjen e drejtpërdrejtë të UNMIK-ut në menaxhimin e AKM-së, dhe fondeve të trustit të AKM-së të cilat mbaheshin në llogaritë e AKM-së, janë siguruar nga UNMIK-ut dhe mbesin nën kontrollin e tij. Veç kësaj, sipas PSSP-së, AKM-ja ka qenë dhe vazhdon të jetë autoritet i përgjithshëm për Kombinatin Trepça (shih vendimin mbi pranueshmërinë e kësaj ankese, i datës 14 prill 2014, § 20).

31. Më 9 dhjetor 2008, përgjegjësia e UNMIK-ut në lidhje me drejtësinë në Kosovë përfundoi me Misionin e Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë (EULEX), i cili mori kontrollin e plotë operacional në fushën e sundimit të ligjit, pasi që kryetari i Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara më 26 nëntor 2008 (S/PRST/2008/44), nxori Deklaratën që mirëpriste angazhimin e vazhdueshëm të Bashkimit Evropian në Kosovë.

32. Më 19 maj 2011, vendimi mbi moratoriumin që pezullonte ankesat e kreditorëve kundër Kombinatit Trepça ishte rinxjerr nga Dhoma e Posaçme. Me sa duket akoma është në fuqi. Nga 8 nëntori i vitit 2011, AKP-ja përsëri filloi t'i mbledhë ankesat e kreditorëve kundër Kombinatit Trepça, i cili përfshin Minierat e Kishnicës. Megjithatë, siç ishte konfirmuar po ashtu nga Njësiti për Riorganizim, derisa vendimi mbi moratoriumin të hiqet apo disi të modifikohet, AKP-ja nuk do t'i shqyrtojë ato ankesa në lidhje me përmbajtjen e tyre.

33. Më 9 dhjetor 2015, me kërkesën e Panelit, gjyqtari kryesues i DHPGJS-së për riorganizimin e NSH-ve konfirmoi që (është ruajtur teksti origjinal):

> "Plani i riorganizimit nuk është përgatitur deri më tani dhe këshilli i kreditorëve nuk është krijuar apo nuk ka mbajtur ndonjë takim.
>
> Dhoma e Posaçme disa herë e ka zgjatur afatin e fundit për dorëzimin e planit të riorganizimit të bazuar në kërkesat e AKP-së dhe vendimi i fundit për zgjatje të këtij afati të fundit deri më 01.11.2016 ishte marrë nga Dhoma e Posaçme më 23 shkurt 2015.
>
> Deri më tani AKP-ja nuk ka dorëzuar plan riorganizimi duke u justifikuar me faktin se Agjencia nuk ka emëruar bordin e drejtorëve dhe ata janë duke pritur një

vendim të merret nga Kuvendi i Kosovës në lidhje me emërimin e bordit. Dhe po ashtu Qeveria e Kosovës mori një iniciativë për të nxjerrë ligj të veçantë për 'Trepçën', në bazë të të cilit do të definohej statusi i kësaj ndërmarrje."

B. Ankesat/procedurat e ankuesve që rrjedhin nga punësimi i tyre në Trepçë

34. Përfaqësuesi i ankuesve, z. Momqillo Nedelkoviq, deklaron se më 17 qershor 1999, KFOR-i britanik largoi me forcë punëtorët joshqiptarë nga objektet e Minierave të Kishnicës dhe u lejoi punëtorëve shqiptarë t'i marrin përsipër minierat. Që nga ajo kohë, ankuesit janë ndaluar të kthehen në vendet e tyre të punës, ndërsa punëtorët shqiptarë thuhet se janë lejuar të kthehen në punë. Kjo ndodhi pavarësisht nga fakti që shumica e punëtorëve kanë ruajtur statusin e tyre të punëtorëve të Minierave të Kishnicës. Në kohën e paraqitjes së ankesës, përfaqësuesi i ankuesve i ofroi Panelit një listë me 667 punëtorë, të cilët ishin në listën e pagave të Minierave të Kishnicës si më 28 shkurt 1999, duke pohuar se shumica e këtyre punëtorëve ishin larguar nga vendet e tyre të punës në mënyrën e përshkruar si më 17 qershor 1999.

35. Sipas përfaqësuesit të ankuesve, me kalimin e viteve ai u është drejtuar disa organizatave, duke përfshirë KFOR-in, Zyrën e IOM-it në Kosovë, Institucionin e Ombudspersonit në Kosovë dhe UNMIK-un, duke kërkuar që punëtorët të lejohen të kthehen në vendet e tyre të punës dhe që të drejtat e tjera të ngjashme të tyre t'u kthehen, por pa ndonjë rezultat pozitiv.

36. Përfaqësuesi i ankuesve deklaron më tutje se që nga ajo kohë punëtorët nuk kanë pranuar as pagë të rregullt e as përfitime të tjera nga punëdhënësi i tyre.

37. Pasi ishte krijuar skema për pensionim të parakohshëm të punëtorëve të Trepçës nga UNMIK-u në vitin 2003 dhe filloi së funksioniuari (shih §§ 15-38), ajo është administruar nga organet relevante në fushën e mirëqenies sociale të IPVQ-ve të Kosovës. Paneli është informuar nga përfaqësuesi i ankuesve se që nga fillimi i këtij programi të pensionimit, më shumë se 200 punëtorë të Minierave të Kishnicës kanë filluar të përfitojnë nga ai.

38. Pas shpalljes së njëanshme të pavarësisë së Kosovës më 17 shkurt 2008 (shih § 28 më lart), një letër (me emrat e personave dhe organizatës) e Republikës së Kosovës ishte bashkëngjitur në formularët e regjistrimit për pensionim të parakohshëm, të cilën menaxhmenti i Kombinatit Trepça në Zveçan refuzoi ta konsiderojë valid. Pasi formularët pa vulë të tillë validiteti nuk pranohen nga autoritetet pensionale të Kosovës, nuk janë pranuar nga autoritetet pas asaj date më shumë aplikacione nga punëtorët që përmbushnin kriteret për marrjen e pensionit të parakohshëm. Ata punëtorë të cilët janë përfshirë në skemë para shkurtit të vitit 2008, akoma pranojnë rregullisht pagesat e pensioneve të tyre.

39. Në kontekst të procesit të riorganizimit të Kombinatit Trepça përmes procedurave të moratoriumit (shih § 23 më lart), AKM-ja ishte përgjegjëse për mbledhjen e ankesave të kreditorëve kundër ndërmarrjes, duke përfshirë ato lidhur me pagat e papaguara ish-punëtorëve dhe punëtorëve të tanishëm. Z. Momqillo Nedelkoviq thekson se në vitin 2006 ai e dorëzoi një ankesë në AKM, duke kërkuar pagesën e pagës së papaguar të fituar në Minierat e Kishnicës (200 euro në muaj), për periudhën nga largimi i tij nga vendi i punës, duke filluar në qershor të vitit 1999. Ai e paraqiti një kopje të ankesës së tij, e cila mban vulën e Shtyllës së UNMIK-ut, BE-së Zyra në Beograd, e cila ishte përgjegjëse për mbledhjen e ankesave të tilla dhe dorëzimin e tyre në AKM; vula mban datën 4 prill 2006. Një letër nga Shtylla e UNMIK-ut, BE-së, Zyra në Beograd tregon se kjo ankesë i ishte

dërguar Njësisë për Ankesa të AKM-së në Prishtinë, më 30 janar 2007. Ai, si përfaqësues i ankuesve tjerë, deklaron më tutje se në vitin 2006 dhe 2007 ankesa të ngjashme ishin dorëzuar nga shumica e punëtorëve tjerë të Minierave të Kishnicës, të cilët ishin larguar me forcë nga puna në qershor të vitit 1999. Megjithatë, sipas tij, asnjëra prej ankesave nuk është shqyrtuar nga AKM-ja.

40. Më 22 nëntor 2013, Njësiti për Riorganizim të Trepçës i AKP-së (Njësiti për Riorganizim) i konfirmoi Panelit se ata janë në posedim të bazës së plotë të të dhënave të AKM-së me regjistrin e të gjitha ankesave të pranuara nga Njësiti i Ankesave i AKM-së. Me kërkesën e Panelit, Njësiti për Riorganizim bëri një kërkim të dhjetë emrave të zgjedhur rastësisht nga lista e lartpërmendur e punëtorëve me etni joshqiptare që nuk ishin lejuar të punonin por akoma ishin në listën e pagave të ndërmarrjes (shih § 34 më lart). Është konfirmuar se ata punëtorë në fakt i kishin dorëzuar ankesat në vitin 2006 para AKM-së; kopjet e ankesave të tyre ishin mbledhur nga Paneli.

41. Njësiti për Riorganizim, po ashtu, ia konfirmoi Panelit se për asnjërën nga ankesat në fakt nuk ishte vepruar nga AKM-ja, sepse procesi i shqyrtimit të tyre ishte, dhe akoma është, i bllokuar nga moratoriumi i Dhomës së Posaçme.

42. Përfaqësuesi i ankuesve deklaron se asnjëri nga ankuesit apo punëtorët në Minierat Kishnicë dhe Novobërdë nuk kishte marrë pagesa mujore që u ishin dhënë punëtorëve joaktivë të Trepçës, të cilët nuk ishin kualifikuar për pensionim të parakohshëm apo të rregullt. Megjithatë, ata nuk kishin dorëzuar ndonjë ankesë te menaxhmenti apo UNMIK-u lidhur me situatën e tyre. Përfaqësuesi i ankuesve po ashtu thekson se, prej vitit 2014, ata minatorë të Kishnicës që kishin pranuar pension të parakohshëm e ndërprenë ta marrin atë.

III. ANKESAT

43. Duke pasur parasysh se ankesa është shpallur e pranueshme, ankuesit ankohen se moratoriumi i shpallur nga Dhoma e Posaçme i parandaloi ata në mënyrë efektive që t'i vazhdojnë tutje ankesat e tyre dorëzuar AKM-së në vitin 2006. Në lidhje me këtë, Paneli konsideron se ata pretendojnë për shkelje të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) neneve 6 (e drejta në qasje në gjykatë) dhe 13 (e drejta për mjet efektiv juridik) e KEDNJ-së.

44. Ankuesit ankohen më tutje rreth dështimit të UNMIK-ut për të zgjidhur situatën e largimit të tyre nga vendet e punës dhe për mosmarrjen e pagave të tyre që nga qershori i vitit 1999. Prandaj, sipas mendimit të Panelit, ata thirren në shkelje të nenit 1 të Protokollit nr. 1 (e drejta për shfrytëzim të qetë të pasurisë) të KEDNJ-së, si dhe nenit 6 (e drejta në punë) të Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (KNDESK).

45. Një grup i ankuesve (punëtorët të cilët nuk ishin të kualifikuar për regjistrim në skemën për pensionim të parakohshëm para 15 qershorit 2008), po ashtu, ankohen se UNMIK-u dështoi t'u ofrojë atyre ndonjë mjet alternativ për të ndihmuar financiarisht veten dhe familjet e tyre. Paneli konsideron se këta ankues pretendojnë për shkelje të neneve 9 (e drejta në sigurim social) dhe 11 (e drejta në standard adekuat të jetesës) e KNDESK-së.

46. Në fund, ankuesit ankohen rreth diskriminimit në situatën e tyre që ka të bëjë *de-facto* me humbjen e punës, mospagesën e pagave dhe përfitimeve tjera, nëpërmjet të cilit janë

krijuar kushte më të favorshme për punëtorët shqiptarë të Kosovës të të njëjtës ndërmarrje. Prandaj, ata në esencë thirren në shkelje të nenit 2 (ndalim i përgjithshëm i diskriminimit), në lidhje me nenet 9 dhe 11 të KNDESK-së.

IV. LIGJI

A. Ligji i aplikueshëm

1. Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2002/13 (13 qershor 2002) *mbi Themelimin e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme në Kosovë për çështjet që ndërlidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit* (më pas e ndryshuar me Rregulloret e UNMIK-ut nr. 2008/4, 2008/19 dhe 2008/29)

Neni 1
THEMELIMI I DHOMËS SË POSAÇME

1.1 Me anë të kësaj themelohet Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që kanë të bëjnë me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit (më tej "Dhoma e Posaçme").

Neni 4
JURIDIKSIONI
4.1 Paneli gjykues i Dhomës së Posaçme ka juridiksion primar për pretendimet dhe kundërpretendimet në lidhje me si në vijim:

…

(g) Të gjitha pretendimet dhe kërkesat në lidhje me riorganizimin dhe ristrukturimin e ndërmarrjeve në pajtim me Rregulloren nr. 2005/48, siç është ndryshuar kohë pas kohe:

…

(l) Çështjet e tjera të tilla siç mund të caktohen me ligj.

…

Neni 14
HYRJA NË FUQI

Siç është ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut nr.2008/4 të datës 5 shkurt 2008:

Neni 4
JURIDIKSIONI (
4.1 Paneli gjykues i Dhomës së Posaçme ka juridiksion primar për pretendimet dhe kundërpretendimet në lidhje me si në vijim:

…

(g) Të gjitha pretendimet dhe kërkesat në lidhje me riorganizimin dhe ristrukturimin e ndërmarrjeve në pajtim me Rregulloren nr. 2005/48, siç është ndryshuar kohë pas kohe:

…

(l) Çështjet e tjera të tilla siç mund të caktohen me ligj.

Neni 14
HYRJA NË FUQI

Rregullorja aktuale hyn në fuqi më 31 mars 2008, deri në të cilën kohë rregullat procedurale të nxjerra sipas nenit 7 duhet përshtatur si duhet.

Siç është ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2008/19 të datës 31 mars të vitit 2008:

Rregullorja aktuale hyn në fuqi më 31 maj 2008…

Siç është me Rregulloren e UNMIK-ut nr.2008/29 të 31 majit 2008:

Rregullorja aktuale hyn në fuqi më 30 qershor 2008…

2. **Udhëzimi Administrativ i UNMIK-ut nr. 2005/7 (2 qershor 2005)** ***për Implementimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2002/13 mbi Themelimin e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme në Kosovë mbi çështjet që ndërlidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit***

Neni 1
Fusha e zbatimit

Ky Udhëzim Administrativ vendos pezullimin e të gjitha veprimeve të caktuara kundër të gjitha aseteve dhe ndërmarrjeve aktualisht nën autoritetin administrativ dhe menaxhimin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit (KTA) të caktuara të jenë pjesë e "Trepçës nën administrim të UNMIK-ut".
…

Neni 3
Pezullimi i zbatimit të veprimeve të caktuara

3.1 Të gjitha veprimet e caktuara kundër apo në lidhje me asetet apo ndërmarrjet që janë nën autoritetin administrativ dhe menaxhimin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit dhe të caktuara të jenë pjesë e Trepçës nën administrim të UNMIK-ut, të cilat bazohen në vendimet e tjera të lëshuara nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që ndërlidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit apo bazuar në vendimet e gjyqit, gjykimet apo vendimet e tjera të lëshuara nga ndonjë gjykatë, organ kuazi gjyqësor apo administrativ, do të pezullohen për një periudhë prej tre muajsh nga data e këtij Udhëzimi Administrativ. Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm mund të zgjasë këtë pezullim të periudhës zbatuese me një instrument pasues legjislativ.

3.2 Asetet dhe ndërmarrjet e caktuara si pjesë e Trepçës nën administrim të UNMIK-ut përfshijnë por nuk kufizohen në si në vijim:
…

(iii) Ndërmarrja Shoqërore Minierat dhe Flotacioni Kishnicë dhe Novobërdë, Prishtinë;

3. **Udhëzimi Administrativ i UNMIK-ut nr. 2005/21 (21 nëntor 2005)** ***për Implementimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2002/13 mbi Themelimin e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme në Kosovë për çështjet që ndërlidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit***

Neni 1
Zgjatja e mëtejme

Periudha e pezullimit të veprimeve zbatuese sipas Udhëzimit Administrativ të UNMIK-ut nr. 2005/7 zgjatet për një periudhë të mëtejme njëmujore nga 1 dhjetori deri më 31 dhjetor 2005.

4. **Udhëzimi Administrativ i UNMIK-ut nr. 2005/48 (21 nëntor 2005)** ***për Riorganizimin dhe Likuidimin e Ndërmarrjeve dhe Aseteve të tyre nën Autoritetin Administrativ të Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit***

Neni 5
Moratoriumi

5.1 Prej datës së vendimit për moratoriumin të gjitha veprimet, procedurat apo aktet e çfarëdo lloji me qëllim zbatimin apo përmbushjen e ndonjë pretendimi kundër ndërmarrjes në fjalë apo aseteve të saj do të pezullohen dhe do të vazhdojnë vetëm me lejen e gjykatës.

…

5.2 Brenda dhjetë (10) ditëve të punës nga data e vendimit për moratorium, Agjencia do të publikojë njoftimin në pajtim me dispozitat e njoftimit në dy ditë pune të njëpasnjëshme dhe fundjavën vijuese.

(a) Njoftimi do të përfshijë informatat vijuese:
(i) datën dhe përshkrimin e vendimit për moratorium;
(ii) një referim për Rregulloren aktuale dhe të drejtat e kreditorëve në pajtim me të; dhe
(iii) që një administrator do të emërohet brenda afatit kohor të specifikuar me nenin 8.1;
(iv) detajet e procesit të dorëzimit të ankesave; dhe
(v) një njoftim për mundësinë për të votuar mbi një plan riorganizimi të ndërmarrjes.

…

5.3 Prej datës së vendimit për moratoriumin deri me datën e emërimit të një administratori, ndërmarrja do të vazhdojë të jetë e menaxhuar nën autoritetin administrativ të Agjencisë, e cila do të ndikojë që ndërmarrja ta përgatis me shpejtësi regjistrimin e krejt pasurisë, aseteve dhe detyrimeve të saj të njohura.

(a) Regjistrimi i krejt pasurisë, aseteve dhe detyrimeve të njohura do të vazhdojë të azhurnohet nga ndërmarrja deri me datën e emërimit të një administratori …

(b) Regjistrimi i krejt pasurisë, aseteve dhe detyrimeve nuk do t'i përfshijë "asetet pensionale" apo "të drejtat e dhëna" siç përkufizohet me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2001/35 "Mbi Pensionet në Kosovë."

5.4 Prej datës së vendimit për moratorium deri me datën e emërimit dhe në pajtim me dispozitat e nënparagrafit 5.5 më poshtë, ndërmarrja do të kërkojë leje paraprake me shkrim nga Agjencia për validitetin e ndonjërit nga transaksionet vijuese:

…

(g) Pagesa e rrogave për punëtorët bëhet me kusht që Agjencia t'i aprovojë pagesat e tilla vetëm deri në nivelin që fondet e shfrytëzuara për pagesat e tilla të jenë

në dispozicion nga të hyrat e ndërmarrjes apo të vihen në dispozicion të ndërmarrjes pjesërisht apo plotësisht nga IPVQ-të, Buxheti i Konsoliduar i Kosovës dhe një donator.

…

Neni 12
Efektet e emërimit dhe veprimet e menjëhershme nga administratori

…

12.2 Administratori, menjëherë pas datës së emërimit dhe në përgatitje të publikimit të njoftimit për emërim dhe mbajtjes së takimit fillestar të kreditorëve, do t'i ndërmarrë veprimet vijuese:

…

(b) Mbajë konsultime me përfaqësuesit e atyre punëtorëve të ndërmarrjes, të cilët pretendojnë të jenë kreditorë të ndërmarrjes …

Neni 31
Regjistrimi dhe vlerësimi i ankesave

…

31.1 Menjëherë pas datës së fundit për ankesa, administratori do të vlerësojë validitetin, shtrirjen dhe prioritetin e ankesave dhe ndonjë zotim të ndërlidhur të kryer apo hipotekë të regjistruar kundër ndërmarrjes.

…

31.4 Nëse administratori refuzon, plotësisht apo pjesërisht, apo zvogëlon shumën e një pretendimi të dorëzuar, ai do të njoftojë sa më shpejt që të jetë e mundur kreditorin e prekur me shkrim, duke ofruar sqarim për refuzimin apo zvogëlimin e pretendimit.

(a) Kreditori i prekur ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës brenda njëzet (20) ditëve të punës nga dërgimi i këtij njoftimi nga administratori për vendimin në lidhje me ankesën e tij dhe dështimi për të bërë ankimim të tillë do t'ia bëjë të pamundur kreditorit ankimimin e mëtejmë ndaj vendimit të administratorit …

(b) Gjykata duhet të caktojë një seancë jo më vonë se dhjetë (10) ditë pune pas dorëzimit të ankesës nga kreditori i prekur dhe do të marrë vendim për ankesën jo më vonë se pesë (5) ditë pune pas mbajtjes së seancës.

Neni 32
Ankesat e paligjshme dhe të papërshtatshme

32.1 Administratori mund të refuzojë ndonjë ankesë apo detyrim që del nga transaksioni nëse:

…

32.2 Kreditori në një ankesë të tillë mund të kundërshtojë ndonjë vendim të administratorit sipas këtij neni në Gjykatë në pajtim me dispozitën e nenit 31.4.

Neni 35
Lista përfundimtare e ankesave

35.1 Jo më vonë se tre (3) muaj pas vlerësimit të të gjitha ankesave, duke përfshirë specifikimin e vërejtjeve kundër vendimit të administratorit nga kreditori i prekur në lidhje me refuzimin apo zvogëlimin e pretendimeve në pajtim me nenin 31, administratori do të përpilojë dhe do t'ia dorëzojë Gjykatës listën përfundimtare të ankesave, duke treguar shumën e tyre dhe statusin në pajtim me kategoritë prioritare të përcaktuara në nenin 36 të Rregullores aktuale.

…

Neni 36
Prioritetet e ankesave

…

(c) Ankesat për këto paga të punëtorëve, të cilat kanë mbetur të papaguara deri me datën e vendimit për moratoriumin, kufizohen deri në pagën bruto tremujore për person …

5. Vendimi për moratorium në rastin SCR-05-001 të datës 9 mars 2006, lidhur me *kërkesën e AKM-së për riorganizimin e Trepçës nën administrimin e UNMIK-ut*

1. Kërkesa e [AKM-së] për riorganizimin e "Trepçës nën administrim të UNMIK-ut" pranohet si në vijim:

   Ndërmarrja të riorganizohet si TREPÇA NËN ADMINISTRIM TË AKM-së, e përkufizuar si:

   Ndërmarrja Themelore Trepça që përbëhet nga:

   …

   (b) NSH Minierat dhe Flotacioni Kishnicë dhe Novobërdë, Prishtinë);

   …

2. Prej datës së vendimit për moratoriumin të gjitha veprimet, procedurat apo aktet e çfarëdo lloji me qëllim zbatimin apo përmbushjen e ndonjë pretendimi kundër Trepçës nën administrim të AKM-së siç është përkufizuar më lart, apo aseteve të saj do të pezullohen dhe do të vazhdojnë vetëm me lejen e kësaj Gjykate në pajtim me nenin 5.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2005/48.
3. Brenda dhjetë (10) Ditësh Pune nga data e këtij Vendimi për Moratorium, AKP do të publikojë një njoftim për këtë në pajtim me nenin 5.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2005/48.

   …

4. Jo më vonë se dy muaj e gjysmë (2 ½) nga data e këtij vendimi për moratorium, AKM-ja do t'ia paraqesë Gjykatës të gjitha ofertat e dorëzuara dhe një raport vlerësimi për Gjykatën, duke përfshirë propozimet për ofertuesit më të përshtatshëm për t'u emëruar nga Gjykata si administratorë dhe ofrues të shërbimit në pajtim me nenet 7 & 8 të Rregullores së UNMIK-ut 2005/48.

E kaluara procedurale dhe faktike:

…

Gjykata pret që AKM-ja të vazhdojë shpejt me marrjen e propozimeve për administratorë dhe ofrues shërbimi dhe të përgatisë regjistrimin e pasurisë siç kërkohet me Rregulloren e UNMIK-ut 2005/48. Nëse ka vonesë të tepruar, secila palë e dëmtuar mund të ankohet në këtë gjykatë për heqjen e këtij moratoriumi …

B. Fusha për t'u shqyrtuar nga Paneli

47. Para se ta shqyrtojë bazueshmërinë e ankesës, Paneli duhet ta qartësojë fushën e shqyrtimit.

48. Paneli thekson se me miratimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/1, më 25 korrik 1999, UNMIK-u mori përsipër obligimin që t'i zbatojë standardet e njohura ndërkombëtarisht për të drejtat e njeriut gjatë ushtrimit të funksioneve të veta. Ky zotim u detajua në Rregulloren e UNMIK-ut nr. 1999/24, të 12 dhjetorit 1999, me të cilën

UNMIK-u mori obligimet sipas këtyre instrumenteve për të drejtat e njeriut: Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe protokollet me të, Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike (KNDCP), KNDESK, Konventa Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor, Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Kundër Grave, Konventa Kundër Torturës dhe Trajtimit apo Dënimit Tjetër Mizor, Jonjerëzor dhe Degradues dhe Konventa për të Drejtat e Fëmijëve.

49. Paneli, po ashtu, thekson që neni 1.2 i Rregullores së UNMIK-ut numër 2006/12, i 23 marsit 2006, mbi themelimin e Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut siguron që Paneli "shqyrton ankesat nga çdo person apo grup individësh që pohojnë të jenë viktimë e shkeljes së të drejtave (të tyre) të njeriut nga UNMIK-u". Pra vetëm aktet apo lëshimet që i atribuohen UNMIK-ut bien brenda juridiksionit *ratione personae* të Panelit. Në lidhje me këtë, duhet përmendur, siç është theksuar më lart, që prej 9 dhjetorit 2008 UNMIK-u nuk ushtron më autoritetin ekzekutiv mbi gjyqësinë e Kosovës dhe aparatin për zbatimin e ligjit. Prandaj, UNMIK-u nuk bart asnjë përgjegjësi për ndonjë shkelje të të drejtave të njeriut që pretendohet se janë kryer nga ato autoritete. Sa i përket ankuesve që ankohen rreth akteve që kanë ndodhur pas asaj date, ato janë jashtë juridiksionit *ratione personae* të Panelit.

50. Po ashtu, Paneli thekson që, sa i përket juridiksionit të vet *ratione materiae*, siç vijon nga neni 1.2 i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12, ai mund t'i shqyrtojë vetëm ankesat që kanë të bëjnë me shkeljet e pretenduara të të drejtave të njeriut. Kjo nënkupton që mundet vetëm t'i shqyrtojë aktet apo lëshimet për të cilat është bërë ankesë rreth pajtueshmërisë së tyre me instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut të cekura më lart (shih § 48).

51. Për sa i përket kompetencës së vet *ratione temporis*, Paneli rikujton se ai ka juridiksion mbi ankesat për shkelje të pretenduara të të drejtave të njeriut që dalin nga faktet që kanë ndodhur para 23 prillit të vitit 2005, vetëm ku këto fakte shkaktojnë një shkelje të vazhdueshme të të drejtave të njeriut (Neni 2 i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12 e datës 23 mars 2006 mbi Themelimin e Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat Njeriut). Në rastin në fjalë, ankuesit janë larguar me forcë nga vendet e tyre të punës më 17 qershor 1999; atyre thuhet se u është ndalur marrja e pagave të rregullta që nga ajo kohë. Derisa vetë ngjarja nuk bie në kuadër të juridiksionit të përkohshëm të Panelit, efektet e tij arrijnë deri në ditën e sotme, dhe në këtë mënyrë përbëjnë një situatë të vazhduar deri me këtë datë.

52. Periudha nën shqyrtim për sa i përket veprimeve të UNMIK-ut në kapacitetin e vet si Administratë e Përkohshme në Kosovë përfundoi më 15 qershor 2008 (shih § 28 më lart), pas të cilës datë UNMIK-u nuk ishte më në gjendje të kryejë efektivisht pjesën më të madhe të detyrave të veta. Megjithatë, periudha nën shqyrtim në lidhje me pretendimet që kanë të bëjnë me funksionimin e gjyqësisë përfundoi më 9 dhjetor 2008, kur pushoi përgjegjësia e UNMIK-ut në lidhje me gjyqësinë në Kosovë (shih § 31 më lart).

C. Parashtresat e palëve

1. Parashtresat e ankuesve

53. Ankuesit ankohen se, pavarësisht nga largimi i tyre me dhunë nga vendi i punës, ata ruajtën statusin e punëtorëve në ndërmarrje. Megjithatë, asnjë pagë nuk u është paguar atyre që nga qershori i vitit 1999. Ata theksojnë se i kanë kërkuar të drejtat e tyre duke iu

drejtuar disa autoriteteve dhe institucioneve në Kosovë, nga autoritetet e UNMIK-ut, deri tek Institucioni i Ombudspersonit në Kosovë (shih § 35 më lart), por pa dobi.

54. Ankuesit deklarojnë më tutje se, në kuadër të procesit të ristrukturimit të Kombinatit Trepça përmes procedurave të moratoriumit, në vitin 2006 ata i kanë paraqitur kërkesë AKM-së për pagesë të pagave të papaguara. Megjithatë kërkesat e tyre janë pezulluar për shkak të vendimit për moratorium të marrë nga Dhoma e Posaçme, duke u bazuar në Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2005/48, e cila akoma është në fuqi. Në anën tjetër, asnjë hap konkret drejt riorganizimit të ndërmarrjes nuk është marrë deri më tani. Ankuesit në esencë ankohen se, për shkak të kësaj situate, e drejta e tyre për qasje në gjykatë, dhe rrjedhimisht, e drejta e tyre në shfrytëzim të qetë të pasurisë, dhe e drejta e tyre në punë janë shkelur.

55. [Ata] ankues, punëtorë të cilët nuk përmbushnin kriteret për regjistrim në skemën për pensionim të parakohshëm prej datës 15 qershor 2008, po ashtu ankohen se ata ishin lënë pa ndonjë mbrojtje sociale për të siguruar standard adekuat të jetesës për veten dhe familjet e tyre.

56. Veç kësaj, ankuesit ankohen se punëtorët shqiptarë të Minierave të Kishnicës ishin trajtuar në mënyrë më të favorshme sesa joshqiptarët.

2. Parashtresat e PSSP-së

57. Në komentet e tij mbi bazueshmërinë të datës 10 qershor 2014, PSSP-ja thekson faktin e pakontestueshëm se punëtorët në fakt ishin larguar nga Minierat e Kishnicës nga KFOR-i, i cili është "një autoritet mbi të cilin UNMIK-u nuk ka mbikëqyrje, kontroll apo autoritet ... [kështu që] UNMIK-u nuk mund të mbahet përgjegjës për veprimet që i atribuohen atij autoriteti." PSSP-ja thekson më tutje se ankesat kanë të bëjnë për mospagesën e pagave dhe diskriminimin që del nga ky largim i pretenduar me dhunë.

58. PSSP-ja argumenton më tutje që ankuesit dështuan të ofrojnë dëshmi për "një të drejtë të ligjshme për pagesë të pagave apo të hyrave tjera në lidhje me punësimin për periudhën që është lëndë e ankesës së tyre aktuale", pasi ata as nuk konfirmuan "statusin e tyre të vazhdueshëm të punësimit në ndërmarrje pas 17 qershorit të vitit 1999, e as që kanë paraqitur ndonjë informatë e cila tregon se është kërkuar ndonjëherë dëmshpërblim në lidhje me largimin e tyre "me forcë", dhe/apo vendimin për statusin e tyre të vazhdueshëm si punëtorë, dhe kështu të vërtetojnë jolegjitimitetin e mungesës së tyre nga vendi i punës pas 17 qershorit të vitit 1999 dhe ndërprerjen e paligjshme të pagave pas asaj date."

59. Sipas mendimit të PSSP-së, në rrethana të tilla, Paneli "mund që mos ta zëvendësojë një gjykatë në mënyrë që të nxjerrë konkluzione, bëjë diskutime dhe arrijë te përfundimet mbi çështjet substanciale ligjore në lidhje me vendimin, ndërprerjen dhe periudhën e punësimit të individëve, duke përfshirë punëtorët/statusin e punëtorit të ankuesve aktualë."

60. Për sa i përket pretendimit të ankuesve se UNMIK-u nuk krijoi një skemë alternative të mbështetjes për ata që nuk ishin të kualifikuar për regjistrim në skemën e pensionimit të parakohshëm, PSSP-ja konsideron se ankuesit thirren në shkelje të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së sipas kësaj pjese të ankesës. Sipas PSSP-së, ankuesit "nuk pohojnë për humbje përfundimtare të të drejtave për pension per se, por më parë, për dështim që t'iu ofrohet një mekanizëm i përkohshëm mbështetjeje deri në një kohë të tillë kur ata do të bëheshin të kualifikuar" për një pension të parakohshëm. Prandaj, PSSP-ja konsideron se "ku punëtorët u kualifikuan, duke u bazuar në kriteret e vendosura ligjore, për pranim të

një shpërblimi për pensionim të parakohshëm i cili u takonte atyre ligjërisht, pagesat e tilla nuk mund të klasifikohen si një "skemë mbështetjeje", siç pretendohet tani nga ankuesit." Prandaj, PSSP-ja e vë në pyetje "nëse ata ankues, të cilët nuk i plotësonin kriteret ligjore për shpërblim për pensionim të parakohshëm, mund të pretendojnë tani të kenë të drejta ekzistuese pronësore në një "skemë mbështetjeje" dhe që të thirren në mbrojtje sipas nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së."

61. Në lidhje me këtë, PSSP-ja i referohet jurisprudencës së GJEDNJ-së (lënda *Van Der Mussele kundër Belgjikës*), e cila qartëson se neni 1 i Protokollit nr.1 nuk garanton të drejtën për të zotëruar një pronë, por që një ankues që pretendon shkelje të të drejtave të tij/saj sipas nenit 1 të Protokollit nr. 1 kërkohet të paraqesë dëshmi *prima facie* të ekzistencës dhe validitetin të pretendimit të tij për atë pronë. PSSP-ja i referohet më tutje rastit tjetër të GJEDNJ-së, *Andrejeva kundër Letonisë*, Ku Gjykata Evropiane qartëson se:

> " ... Neni 1 i Protokollit nr. 1 nuk vendos asnjë kufizim në lirinë që i jepet shtetit që është palë në marrëveshje të vendosë nëse do të krijojë apo jo ndonjë formë të skemës së sigurimit social, apo nëse do të zgjedhë apo jo ndonjë lloj apo sasi të përfitimeve për t'i ofruar nën një skemë të tillë. Nëse, megjithatë, një shtet që është palë në marrëveshje e ka në fuqi legjislacionin që siguron pagesë si për të drejtë në një përfitim për mirëqenie-pavarësisht nëse është i kushtëzuar apo jo me pagesë paraprake të kontributeve-ai legjislacion mund të vlerësohet se gjeneron një interes material që bie në kuadër të fushëveprimit të nenit 1 të Protokollit nr. 1 për personat që u plotësohen kërkesat e veta".

62. Prandaj, PSSP-ja përfundon që "nuk ka asnjë bazë ligjore në ligj për krijim të obligueshëm të një skeme të mirëqenies sociale". Veç kësaj, "vetëm ata ankues që i kanë përmbushur kushtet ligjore sipas skemës për pensionim të parakohshëm për punëtorët e Trepçës mund të pretendojnë se kanë një të drejtë ekzistuese dhe të identifikueshme për pagesë të pensionit të parakohshëm në mënyrë që të ketë një pritje legjitime për shfrytëzimin e të drejtave që ndërlidhen me atë të drejtë." Si rrjedhim, sipas PSSP-së, "ankuesit të cilët nuk i kanë përmbushur kriteret ligjore për pagesë shpërblimi për pensionim të parakohshëm, kanë dështuar të provojnë ekzistencën e një të drejte pronësie në një "skemë mbështetjeje", që bie në kuadër të fushëveprimit të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.

63. PSSP-ja përsërit pikën që ankuesit dështuan të ofrojnë dëshmi se "largimi i tyre i pretenduar nga vendi i punës dhe në këtë mënyrë veprimi në shkelje të së drejtës së tyre në punë i atribuohet UNMIK-ut apo që legjislacioni që përcakton kriteret për kualifikim për pagesë për pensionim të parakohshëm ishte implementuar në një mënyrë jo të drejtë dhe arbitrare".

64. Duke komentuar të drejtën për të pasur qasje në drejtësi, PSSP-ja rikujton se më 14 dhjetor 2005, "AKM … i bëri një kërkesë Dhomës së Posaçme për fillimin e riorganizimit të Trepçës [e cila është] një NSH e rëndësishme në një zonë gjeografike në Kosovë me ndjeshmëri të lartë politike. Një kërkesë për vendosje të një moratoriumi, i cili mund të ketë për efekt suspendimin e të gjitha veprimeve për zbatim apo përmbushje të pretendimeve kundër Trepçës … është konsideruar e nevojshme për të mbrojtur dhe ruajtur NSH-në dhe asetet e saj, derisa krijohet një regjim i ristrukturimit për Trepçën që mundëson një trajtim të rregullt të të gjitha borxheve të Trepçës, trajtim të barabartë të të gjithë kreditorëve të Trepçës dhe riorganizim të ndërmarrjes."

65. PSSP-ja vazhdon që "me qëllimin që të veprohet në interes të të gjithë aksionarëve, punëtorëve, kreditorëve dhe pretenduesve për të mbrojtur dhe ruajtur asetet e Trepçës dhe NSH-ve të saj të afërta, asnjë interes, e drejtë apo kërkesë e një grupi të veçantë nuk mund të vendoset para të tjerave dhe t'i jepen vëmendje dhe privilegje të veçanta nga AKM-ja. Qëllimi i procesit të riorganizimit ishte të ofrohet një platformë e barabartë për vlerësimin dhe mbrojtjen e të drejtave të palëve të interesuara ndërsa zhvillohet një proces transparent dhe i drejtë i ristrukturimit të NSH-së."

66. PSSP-ja po ashtu thekson që, megjithëse "*Rregullorja e UNMIK-ut 2005/48* i ofron AKM-së mundësinë të kërkojë nga Dhoma e Posaçme vendosjen e një moratoriumi në rrethana të caktuara, vendimi aktual i arsyetuar i marrë nga Dhoma e Posaçme nuk mund të konsiderohet një akt që i atribuohet UNMIK-ut apo AKM-së." Duke iu referuar qëndrimit të marrë nga Paneli në rastin *LINDA, Limited Liability Company (LINDA, Kompani me përgjegjësi të kufizuara)* (nr. 45/08), PSSP-ja thekson që "nuk është funksioni i Panelit të veprojë si një gjykatë në çështjet ku një tribunal kompetent ka bërë shqyrtim të kujdesshëm dhe ka dhënë arsye për vendimet e veta të cilat nuk janë arbitrare dhe të padrejta."

67. Veç kësaj, PSSP-ja thekson që (është ruajtur theksi) "në gjykimin e vet për vendim për moratorium (SCR-05-001), Dhoma e Posaçme siguron në mënyrë specifike shqyrtim gjyqësor të vendimit të saj duke gjykuar që *'[N]ëse ka vonesë të tepërt, secila palë e dëmtuar mund të kërkojë nga kjo Gjykatë heqjen e moratoriumit'*." Ai vazhdoi në lidhje me këtë se "Ankuesit nuk kanë ofruar asnjë dëshmi për të dëshmuar se ishte dorëzuar ndonjëherë ankesë në Dhomën e Posaçme nga ankuesit që kundërshtonte vendimin për moratorium, apo që Dhoma e Posaçme ka qenë joefektive në gjykimin e çështjeve të tilla në kuadër të kompetencës së vet." Prandaj, PSSP-ja përfundon se "kur nuk është dorëzuar ankesë e tillë në Dhomën e Posaçme, ankuesit nuk mund të pretendojnë se UNMIK-u është njoftuar efektivisht për ndonjë ankesë të tillë."

68. PSSP-ja, po ashtu, parashtron se "Ankuesit nuk mund të pohojnë që veprimi gjyqësor i ndërmarrë nga Dhoma e Posaçme ishte në shpërputhje me qëllimin e kërkuar që të realizohet apo që ata kanë mbajtur një peshë të tepërt në lidhje me pretenduesit e tjerë të Trepçës." Sipas mendimit të PSSP-së, fakti që moratoriumi është rinxjerrë më 19 maj 2011 dhe tani është në fuqi, "mbështet në mënyrë të konsiderueshme bindjen se shqetësimet e interesit publik lidhur me riorganizimin e Trepçës vazhdojnë të mbesin valide deri më tani."

69. PSSP-ja nuk jep asnjë koment mbi përmbajtjen e ankesave në pritje e sipër në AKM, të cilat, sipas mendimit të tij, duhet të gjykohen në kuadër të juridiksionit të një gjykate kompetente "pa interferencë administrative".

70. Në fund, PSSP-ja ia tërheq vëmendjen Panelit për "nxjerrjen nga ana e UNMIK-ut të rregulloreve të ndryshme, të cilat krijuan një kornizë ligjore për administrim të NSH-ve si dhe krijimin nga AKM-ja të procedurës së riorganizimit në rastin e Trepçës dhe NSH-ve të saj të afërta". Sipas mendimit të PSSP-së, ato veprime dëshmojnë se "pretendimet e ngritura nga ankuesit që nuk ishte vepruar nga AKM-ja lidhur me ankesat e kreditorëve të të Trepçës si dhe punëtorët për NSH-të e saj të afërta nuk janë të qëndrueshme."

71. Në komentet e tij të pranuara nga Paneli më 9 shkurt 2016, në lidhje me vendimin për moratorium të marrë nga DHPGJS (shih §§ 7 dhe 33 më lart), PSSP-ja shton se Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2005/48 nuk përmban një dispozitë për të drejtën e ankimimit

të vendimit për një moratorium "si të tillë". Megjithatë, sipas PSSP-së, elementet e tjera të Rregullores së njëjtë tregojnë se "forma të ndryshme të mjeteve juridike, veç ankesave" mund të jenë në dispozicion të palëve të dëmtuara, duke përfshirë "vendim paraprak gjyqësor". PSSP-ja shton se, megjithëse Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2005/48 nuk e specifikon një procedurë për të pasur një mjet të tillë juridik, ajo "qartas tregon që DHPGJS ka kompetencë të shqyrtojë çështjen dhe vendos për pretendimet kundër një ndërmarrje, siç është ai i ngritur nga ankuesit, ndërsa vendimi për moratorium është në vend". PSSP-ja thekson më tutje që, për shkak se nuk kishte asnjë të drejtë për shqyrtim gjyqësor të kodifikuar në statut, në vendimin për moratorium thuhet në paragrafin e tij të fundit në fuqi që "nëse ka vonesë të tepërt, secili person i dëmtuar, mund të kërkojë" nga DHPGJS heqjen e moratoriumit.

72. PSSP-ja, po ashtu, thekson se Udhëzimi Administrativ i UNMIK-ut nr. 2006/17, i ndryshuar dhe zëvendësuar me Udhëzimin Administrativ të UNMIK-ut nr. 2008/6 të 11 qershorit të vitit 2008, paraqiti nocionin e shqyrtimit gjyqësor të gjykimeve dhe vendimeve të Dhomës së Posaçme. Megjithatë, PSSP-ja pranon se UNMIK-u "nuk është në dijeni se UA është bërë ndonjëherë i aplikueshëm retroaktivisht, që nënkupton se ankuesit janë parandaluar në aspektin kohor nga ndjekja e një shqyrtimi apo apelimi" në pajtim me këto udhëzime administrative.

73. Për sa i përket procedurave të riorganizimit të Kombinatit Trepça, në pritje para DHPGJS, PSSP-ja thekson se Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2005/48 përcakton se punëtorët e NSH-ve duhet të konsultohen në procesin e riorganizimit, "si dhe mjetet për kreditorët për t'i kundërshtuar veprimet e administratorit apo kërkuar sqarime për mënyrën e qasjes në DHPGJ". Megjithatë, PSSP-ja pranon se "asnjëra nga këto nuk do të ishte e aplikueshme në këtë kohë duke pasur parasysh se asnjë administrator nuk është emëruar".

74. PSSP-ja, po ashtu, pranon se "realitetet politike në terren fatkeqësisht interferuan në administrimin dhe riorganizimin efikas të NSH-së Trepça" dhe që, deri më tani, nuk është emëruar asnjë administrator për të mbikëqyrë procesin e riorganizimit, në shkelje të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2005/48. Megjithatë, këto realitete politike dhe vonesa në trajtimin e pretendimeve të ngritura nga ankuesit "nuk mund t'i atribuohen UNMIK-ut, veçanërisht në dritë të faktit që në çdo kohë, ankuesit kanë mundur t'i ushtrojnë të drejtat e përshkruara më lart para DHPGJS-ë".

75. Në përgjigje të pretendimit të ankuesve se ata janë diskriminuar, PSSP-ja, së pari rikujton se në fazën e pranueshmërisë Paneli ishte i kënaqur që ankuesit mjaftueshëm krijuan një rast *prima facie* të diskriminimit. Po ashtu, në atë kohë Paneli konsideroi se, sipas Ligjit kundër Diskriminimit (të nxjerrë me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2004/32 të 20 gushtit të vitit 2004, *Mbi Nxjerrjen e Ligjit kundër Diskriminimit të miratuar nga Kuvendi i Kosovës*), barra për të dëshmuar se kjo pjesë e ankesës nuk është e bazuar i bie PSSP-së.

76. Megjithatë, PSSP-ja, përsëri, thekson se "Ndërsa ankuesit paraqesin disa pretendime të përgjithshme dhe të pabazuara në deklaratën e tyre të ankesave, nuk ka diskutim se gjeneza e ankesës lidhur me diskriminimin kundër punëtorëve joshqiptarë rrjedh drejtpërdrejt nga largimi i pretenduar i dhunshëm i joshqiptarëve nga Minierat e Kishnicës" dhe që ky veprim nuk i atribuohet UNMIK-ut.

77. PSSP-ja thekson më tutje se ankuesit "nuk pretendojnë se korniza legjislative mbi diskriminimin e krijuar në Kosovë ishte joadekuate, e pamjaftueshme apo jokompatibile me standardet e pranueshme për të drejtat e njeriut për sa i përket mbrojtjes së lirisë së

tyre nga diskriminimi, në mënyrë që të atribuohet diskriminimi i pretenduar … deri te një dështim nga ana e UNMIK-ut.”

78. PSSP-ja, po ashtu, nënvizon se pretendimet për diskriminim sipas nenit 14 duhet mbrojtur në pajtim me disa të drejta të tjera substanciale në KEDNJ. Pasi, sipas PSSP-së, “Ankuesit nuk kanë vendosur një pretendim sipas nenit 14 në kuadër të fushëveprimit të ndonjë të drejte tjetër të mbrojtur sipas KEDNJ-së dhe … akti diskriminues nuk i atribuohet UNMIK-ut, ankesa bie jashtë fushëveprimit të juridiksionit *ratione personae* të PKDNJ-së.

79. Në fund, duke rikujtuar të gjeturën e mëhershme të Panelit se largimi i ankuesve nga vendet e tyre të punës ishte një akt i çastit, i cili nuk sjellë deri te një situatë e mundshme e vazhdueshme, PSSP-ja konsideron se kjo pjesë e ankesës nuk përfshin një shkelje të vazhdueshme të të drejtave të njeriut. Prandaj, sipas PSSP-së, “aktet e pretenduara të diskriminimit nga ana e UNMIK-ut nuk janë të qarta.”

D. Shkelja e pretenduar e neneve 6 dhe 13 të KEDNJ-së, dhe nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së

1. Qasja në gjykatë

a. Parimet e përgjithshme

80. Paneli rikujton se garancitë e vendosura në nenin 6 § 1 të KEDNJ-së i sigurojnë secilit, *inter alia*, të drejtën që ndonjë pretendim në lidhje me të drejtat dhe obligimet e tij/saj civile të sillen para një gjykate apo tribunali; në këtë mënyrë materializohet “e drejta në gjykatë”, nga e cila e drejta në qasje, që është e drejta për të krijuar procedura para gjykatave në çështje civile, përbën njërin aspekt (shih GJEDNJ, *Golder kundër Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i 21 shkurtit të vitit 1975, *publikimet e gjykatës*, Seria A, nr. 18, ff. 13-18, §§ 28-36).

81. Paneli, megjithatë, thekson se kjo e drejtë nuk është absolute, por mund t’u nënshtrohet kufizimeve; këto lejohen me nënkuptim meqë e drejta në qasje me vetë natyrën e saj kërkon rregullim nga autoritetet kompetente. Në lidhje me këtë, autoritetet kanë një margjinë të caktuar të vlerësimit. Megjithatë, kufizimet e vendosura nuk duhet të kufizojnë apo zvogëlojnë qasjen që u është lënë individëve në një mënyrë të tillë apo në një nivel të tillë që vetë esenca e të drejtës është cenuar. Për më tepër, një kufizim nuk do të jetë në përputhje me nenin 6 § 1 të KEDNJ-së nëse nuk ndjek një qëllim legjitim dhe nëse nuk ka një marrëdhënie të arsyeshme të proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që kërkohet të arrihet (shih: GJEDNJ, *Stubbings dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i 22 tetorit të vitit 1996, *Raportet e gjykimeve dhe vendimeve*, 1996-IV, f. 1502, § 50; GJEDNJ [DHL], *Markoviq dhe të tjerët kundër Italisë*, nr. 1398/03, vendimi i 14 dhjetorit të vitit 2006, § 99).

b. Aplikimi i atyre parimeve në rastin aktual

82. Në fillim, Paneli konsideron se faktet vijuese nuk janë kundërshtuar nga palët:

- Ankuesit janë larguar me forcë nga vendet e tyre të punës në vitin 1999 dhe ata faktikisht nuk kanë punuar në ndonjë objekt të Kombinatit Trepça që nga ajo kohë;
- Ankuesit nuk marrin paga të rregullta që nga *de facto* koha e largimit të tyre nga vendet e punës;

- Megjithatë, ankuesit mbetën të punësuar nga Kombinati Trepça së paku deri në kohën që ata paraqitën ankesat e tyre në AKM për pagat e papaguara;
- Ankuesit nuk paraqitën ndonjë ankesë në lidhje me gjendjet e tyre në ndonjë gjykatë të rregullt në Kosovë;
- Në dhjetor të vitit 2005, AKM-ja inicioi procedurën e riorganizimit për Kombinatin Trepça dhe e çoi para DHPGJS-ë për ta pasur procesin të autorizuar, siç kërkohet me Rregulloren e UNMIK-ut nt. 2005/48;
- Pas ndjekjes së procedurës së duhur, DHPGJS dha leje për të inicuar riorganizimin e Kombinatit Trepça dhe më pas nxori moratoriumin, i cili *de facto* ndaloi ndonjë autoritet të shqyrtojë ndonjë lloj të pretendimeve materiale kundër ndërmarrjes;
- Pas shpalljes së moratoriumit në gazeta, ankuesit, së bashku me personat e tjerë që kishin interes financiar në Kombinatin Trepça, paraqitën ankesat e tyre në AKM, në të cilat ata ankoheshin për pagat e papaguara (200 euro/në muaj) dhe kërkuan aksione nga procesi i privatizimit të ndërmarrjes;
- Sipas ligjit të aplikueshëm, ndërsa moratoriumi është në fuqi, AKM-ja është dashur të ndërmarrë veprime të caktuara me qëllim te riorganizimit të Kombinatit Trepça, duke përfshirë mbledhjen dhe analizën e pretendimeve të të gjithë kreditorëve;
- Moratoriumi kurrë nuk është hequr nga DHPGJS gjatë periudhës ndërsa UNMIK-u ishte përgjegjës për administrimin e drejtësisë në Kosovë; ai akoma është në fuqi, dhe për herën e fundit është rishpallur në shkurt të vitit 2015.

83. Paneli rikujton se që nga miratimi i Rregullores së UNMIK-ut 2002/13, e cila hyri në fuqi më 13 qershor 2002, të gjitha "[a]nkesat, duke përfshirë ankesat e kreditorëve apo për pronësi, të paraqitura kundër një ndërmarrje apo korporate tani apo më parë nën autoritetin administrative të [AKM-së], ku ankesat e tilla dolën gjatë apo para kohës që ndërmarrja apo korporata e tillë është apo ishte subjekt i autoritetit administrativ të [AKM-së]" duhej paraqitur DHPGJS-ë (shih p.sh. PKDNJ, *DEPOSIT INSURANCE AGENCY (AGJENCIA PËR SIGURIMIN E DEPOZITAVE)*, nr. 59/10, vendimi i 26 tetorit të vitit 2011 dhe *Jugobanka A.D. nën likuidim I* dhe *II*, nr. 56/10 dhe 57/10, vendimet e 6 qershorit të vitit 2013).

84. Megjithatë, që nga miratimi, në qershor të vitit 2005, i Udhëzimit Administrativ të UNMIK-ut nr. 2005/7 (shih § 22 më lart), të gjitha "veprimet e caktuara të drejtuara kundër apo në lidhje me asetet ... e Trepçës nën administrim të UNMIK-ut", ishin pezulluar, fillimisht për tre muaj. Në praktikë, asnjë proces ligjor kundër Kombinatit Trepça, madje edhe nëse një paditës kundër ndërmarrjes do t'ia arrinte të sigurojë vendim të favorshëm, nuk mund të përfundohej. Vendimi për moratorium i marrë nga DHPGJS në mars të vitit 2006 e zgjati këtë pezullim, deri me përfundimin e riorganizimit të Kombinatit Trepça nga AKM-ja.

85. Megjithatë, vendimi i njëjtë për moratorium po ashtu u tregonte të gjithë kreditorëve (palëve të interesuara) se kishte një mekanizëm tjetër për t'i shqyrtuar e ndoshta përmbushur pretendimet e tyre materiale, që ishte një ftesë për t'i paraqitur pretendimet e tyre materiale kundër Kombinatit Trepça në AKM.

86. Paneli rikujton që ankuesit nuk adresuan ankesat e tyre përmes sistemit ekzistues gjyqësor, para se t'i paraqisnin ankesat e tyre në AKM, në vitin 2006. Megjithatë, kjo periudhë kohore është jashtë juridiksionit kohor të Panelit të sqaruar më lart (shih §§ 51 - 52). Në vend të kësaj, Paneli do të përqendrohet në periudhën kohore pasi ata dorëzuan ankesat e tyre në AKM, pas ftesës në vendimin për moratorium që ta bëjnë këtë, e cila është nën juridiksionin e tij kohor.

87. Paneli pajtohet që nxjerrja e një moratoriumi, duke ndalur të gjitha procedurat ekzistuese kundër Kombinatit Trepça dhe parandaluar që të gjykohen rastet e reja, nuk është *per se* një masë jolegjitime, pasi ajo është e dizajnuar t'i mbrojë interesat e të gjithë kreditorëve të një ndërmarrje e cila është duke u riorganizuar. Në të vërtetë, për shkak të moratoriumit, DHPGJS pezulloi procedurat në zhvillim e sipër të nisura nga një kreditor i Trepçës (shih Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut (PKDNJ), *Jugobanka A.D. nën likuidim I*, përmendur në § 90 më lart, në § 15). Nga kjo rrjedh se vetë moratoriumi nuk e parandaloi AKM-në nga shqyrtimi i ankesave të ankuesve të paraqitura para saj. Përkundrazi, ai është dizajnuar në mënyrë specifike për të krijuar "kushte të tilla ideale" që i mundësojnë AKM-së të bëjë vlerësimin më të mirë të mundshëm të situatës ekonomike të ndërmarrjes dhe të propozojë zgjidhjen më të mirë, duke marrë parasysh plotësisht interesat e të gjitha palëve. Në këtë situatë, procedura e AKM-së, po ashtu "e mbrojtur" nga moratoriumi, mbeti mekanizmi i vetëm për secilin kreditor të Kombinatit Trepça, për t'i adresuar pretendimet e tyre materiale kundër ndërmarrjes.

88. Megjithatë, sipas Rregullores 2005/48 (nenet 31–35), të gjitha ankesat duhej të trajtoheshin nga administratori i emëruar nga AKM-ja vetëm pasi plani i riorganizimit të miratohet nga Dhoma e Posaçme. Vetëm atëherë administratori mund të vlerësojë dhe vendosë nëse ankesa e caktuar duhet të përfshihet në listën përfundimtare të ankesave apo të refuzohet.

89. Paneli e pranon se ky moratorium ishte shoqëruar nga një plan i lidhur me kohën për veprime konkrete për t'u ndërmarrë në lidhje me ndërmarrjen, e cila ishte vënë në riorganizim. Në veçanti, DHPGJS kërkoi nga AKM-ja t'i paraqesë asaj dëshmi se këto veprime ishin duke u implementuar. Për atë çështje, në moratoriumin thuhej se "[g]jykata pret që AKM-ja të vazhdojë shpejt me marrjen e propozimeve për administratorë dhe ofrues të shërbimeve dhe të përgatisë regjistrimin e pasurisë" si dhe të caktojë një afat të fundit prej 2.5-muajsh për AKM-në që ta bëjë këtë.

90. Megjithatë, siç i është konfirmuar Panelit nga DHPGJS, asnjë veprim i paraparë me Rregulloren e UNMIK-ut 2005/48 në fakt nuk ishte ndërmarrë nga AKM-ja. Duke iu përgjigjur kërkesës së vet për informata, më 9 dhjetor 2015 DHPGJS e informoi Panelin që (është ruajtur teksti origjinal):

    "*Plani i riorganizimit nuk është përgatitur deri më tani dhe këshilli i kreditorëve nuk është krijuar apo mbajtur ndonjë takim. ... Deri më tani AKP-ja nuk e ka paraqitur planin e riorganizimit duke u arsyetuar me faktin se Agjencia nuk e ka caktuar bordin e drejtorëve...*".

91. Pasi AKM-ja dështoi t'i kryente procedurat e riorganizimit, ankesat e ankuesve nuk janë vlerësuar, dhe, më pas, mbetën pa ndonjë vendim mbi bazueshmërinë e tyre. Prandaj, ankuesit nuk kanë pranuar kurrë një vendim për pretendimet e tyre për interesa materiale në Kombinatin e Trepçës (pagesa e pagave të mbetura borxh). Në të njëjtën kohë, për shkak të vendimit për moratorium, DHPGJS nuk mundi që vetë t'i vlerësojë këto ankesa.

92. Paneli nuk e ka asnjë dyshim se prona e Kombinatit Trepça është jashtëzakonisht me vlerë. Megjithatë, Kombinati po ashtu ka akumuluar borxhe domethënëse që kërkon nga autoritetet në Kosovë të kenë qasje jashtëzakonisht të kujdesshme ndaj riorganizimit të saj. Në anën tjetër, interesave të kreditorëve, si dhe pjesëtarëve të fuqisë punëtore domethënëse të Kombinatit Trepça, është dashur gjithashtu t'u kushtohet konsideratë e duhur. Nuk ka aspak dyshim se riorganizimi i kësaj ndërmarrje është një proces shumë

kompleks dhe multidimensional, i cili kërkon kohë. Veç kësaj, riorganizimi i Kombinatit Trepça me sa duket varet nga marrëveshja politike ndërmjet autoriteteve në Beograd dhe Prishtinë, për të cilën UNMIK-u duket të ketë pak apo kurrfarë kontrolli, por vetëm mund të bëjë përpjekje që të ndihmojë.

93. Paneli, po ashtu, rikujton se kufizimet e vendosura duhet të jenë "të arsyeshme dhe [duhet të gjejnë] një balancë të gjerë në mes interesave të shtetit dhe atyre të individit" (GJEDNJ, *Sokur kundër Ukrainës*, nr. 29439/02, vendimi i 26 prillit të vitit 2005, § 32, shih gjithashtu PKDNJ, *Millogoriq dhe të tjerët*, nr. 38/08 et al, mendimi i 24 marsit të vitit 2010, § 40). Me fjalë tjera, një balancë duhet të ekzistojë në mes interesave të përbashkëta (të ndërmarrjes/shtetit/shoqërisë) dhe interesave të kreditorëve individualë. Për shembull, në një situatë ku një numër i rëndësishëm i ankesave për shuma të mëdha parash paraqitet kundër një shteti, kjo mund të kërkojë rregullim të mëtejmë nga shteti. Në lidhje me këtë shtetet e kanë një margjinë të caktuar të vlerësimit, por masat e miratuara duhet të jenë në përputhje me nenin 6 § 1 të KEDNJ-së (shih GJEDNJ, *Kutiq kundër Kroacisë*, nr. 48778/99, vendimi i 1 marsit të vitit 2002, *KEDNJ*, 2002-II, § 31).

94. Në rastin aktual, megjithatë, duket se ndonjë mundësi për të pasur një proces civil kundër Kombinatit Trepça, të gjykuar nga një gjykatë është ndalur deri më tani për mbi dhjetë vjet, tri nga të cilat pothuaj bien në kuadër të juridiksionit *ratione temporis* të Panelit. Kjo ishte pasojë e dështimit të vazhdueshëm të AKM-së për të ndërmarrë hapa relevantë për riorganizimin e Kombinatit Trepça dhe më pas të vendosë mbi ankesat e ankuesve, si dhe moratoriumin mbi procedurat civile kundër Kombinatit Trepça. Në këto rrethana, Paneli nuk mund ta pranojë që shkalla e qasjes së ofruar sipas legjislacionit të aplikueshëm ishte e mjaftueshme të sigurojë "qasje në gjykatë" për ankuesit.

95. Prandaj, Paneli konstaton se kjo situatë përbën shkelje të nenit 6 § 1 të KEDNJ-së.

2. E drejta për mjet efektiv juridik

a. Parimet e përgjithshme

96. Paneli rikujton se parimet e lidhura me nenin 13 të Konventës Evropiane garantojnë se një mjet juridik në lidhje me shkeljen e pretenduar të të drejtave, i cili është i mjaftueshëm të korrigjojë shkeljen dhe, nëse është e aplikueshme, të ofrojë kompensim, duhet të jetë në dispozicion në kohën relevante për personin e dëmtuar në teori dhe praktikë (shih: GJEDNJ, *Klass dhe të tjerët kundër Gjermanisë*, nr. 5029/71, vendimi i 6 shtatorit të vitit 1978, §§ 64 dhe 67; GJEDNJ [DHL], *Kudła kundër Polonisë*, nr. 30210/96, vendimi i 26 tetorit të vitit 2000, 157; GJEDNJ, *Melnik kundër Ukrainës*, nr. 72286/01, vendimi i 28 marsit të vitit 2006, § 114).

97. Veç kësaj, sipas Gjykatës, "autoriteti" i përmendur në atë dispozitë nuk do të thotë domosdoshmërisht të jetë një autoritet gjyqësor; por nëse nuk është, fuqitë e tij dhe garancitë që jep janë relevante për të përcaktuar nëse mjeti juridik para tij është efektiv. Po ashtu, madje edhe nëse një mjet i vetëm juridik nuk plotëson vetvetiu kërkesat e nenit 13, totali i mjeteve juridike të ofruara me ligjin vendor mund ta bëjë këtë (shih, në mes autoriteteve tjera, *Silver dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar* vendimi i 25 marsit të vitit 1983, Seria A nr. 61, f. 42, § 113; *Chahal kundër Mbretërisë së Bashkuar* vendimi i 15 nëntorit të vitit 1996, raportet 1996-V, ff. 1869-70, § 145).

98. Veç kësaj, sipas Gjykatës, "efektiviteti" i një "mjeti juridik" në kuadër të kuptimit të nenit 13 nuk varet në sigurinë e një rezultati të favorshëm për ankuesin. Në të njëjtën

kohë, mjeti juridik i kërkuar me nenin 13 duhet të jetë "efektiv" në praktikë si dhe në të drejtën, në kuptimin që ose të parandalojë shkeljen e pretenduar apo vazhdimin e saj, ose të ofrojë kompensim adekuat për ndonjë shkelje që tanimë ka ndodhur, dhe duhet të ofrojë gjasa të arsyeshme për sukses (shih GJEDNJ [DHL], *Kudła kundër Polonisë*, nr. 30210/96, vendimi i 26 tetorit të vitit 2000, §§ 157-158; GJEDNJ, *Wasserman kundër Rusisë (nr. 2)*, nr. 21071/05, vendimi i 10 prillit të vitit 2008, § 45; GJEDNJ, *Vlad dhe të tjerët kundër Rumanisë*, nr. 40756/06, 41508/07 dhe 50806/07, vendimi i 26 nëntorit të vitit 2013, § 111).

99. Gjykata Evropiane, po ashtu, ka gjetur në shumë raste se nuk ka nevojë të shqyrtohen ndaras pretendimet sipas nenit 13, kur një shkelje e nenit 6 është gjetur, pasi "Neni 6 § 1 mendohej të përbëj një *lex specialis* në lidhje me nenin 13". Megjithatë, Gjykata po ashtu ka gjetur se situata është ndryshe në raste ku ankuesit i mungon një mjet juridik kundër një shkelje të pretenduar të nenit 6, në veçanti të kohëzgjatjes së procedurave (shih GJEDNJ [DHL], *Kudła kundër Polonisë*, përmendur në § 96 më lart, në § 156; GJEDNJ, *Vlad dhe të tjerët kundër Rumanisë*, përmendur në § 97 më lart, në § 111).

100. Siç është sqaruar nga Gjykata Evropiane, çështja nëse ankuesi në një rast "përfitoi nga gjykimi brenda një kohe të arsyeshme në procesin për të drejtat dhe obligimet civile ... është një çështje e ndarë ligjore nga ajo nëse kishte në dispozicion të ankuesit sipas ligjit vendor një mjet juridik për të shqyrtuar një ankesë mbi këtë bazë. … [Ekziston një] nevojë të shqyrtohet ankesa e ankuesit sipas nenit 13 e marrë ndaras, pavarësisht të gjeturës së vet të mëhershme të një shkelje të nenit 6 § 1 për dështim për ta gjykuar atë brenda një kohe të arsyeshme (GJEDNJ [DHL], *Kudła*, përmendur më lart, §§ 147-149). Veç kësaj, "kërkesat e nenit 13 duhet parë si përkrahje të atyre të nenit 6 § 1, më parë se të jenë të absorbuara nga obligimi i përgjithshëm i caktuar me atë nen (*ibid*., § 153).

101. Paneli konsideron se një qasje e ngjashme në lidhje me ankesën sipas nenit 13 të KEDNJ-së, në lidhje me një shkelje të së drejtës për qasje në gjykatë sipas nenit 6 § 1 të KEDNJ-së, duhet të vlejë.

b. Aplikimi i atyre parimeve në rastin aktual

102. Paneli rikujton që teksti i vendimit për moratorium paraqet mundësinë e një kërkese për DHPGJS për ta hequr moratoriumin: "[n]ëse ka vonesë të tepërt, secila nga palët e dëmtuara mund t'i bëjë kërkesë kësaj gjykate që ta heqë këtë moratorium." Megjithatë, vendimi për moratorium është shpallur në një gazetë në një formë të shkurtuar, e cila nuk e përfshinte atë rresht, ndërsa teksti i plotë i vendimit për moratorium nuk u është shpërndarë kurrë të gjitha palëve të interesuara, duke përfshirë ankuesit. Prandaj, Paneli përfundon se palët nuk ishin të informuara për një mundësi të tillë, siç paraqitet në tekstin e vendimit për moratorium, në kohën kur është nxjerrë.

103. Në të njëjtën kohë, Paneli thekson se vetëm me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2008/4 të 5 shkurtit të vitit 2008 (Neni 4.1(g)), Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2002/13 *Mbi Themelimin e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës mbi çështjet e ndërlidhura me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit*, u ndryshua për ta përfshirë në juridiksionin e DHPGJS-ë, *inter alia*, të drejtën për të shqyrtuar "[të] gjitha pretendimet dhe kërkesat në lidhje me riorganizimin apo ristrukturimin e ndërmarrjeve sipas Rregullores nr. 2005/48." Paneli, po ashtu, thekson se data e parë e hyrjes në fuqi të kësaj dispozite ishte shtyrë dy herë nga dy rregulloret pasuese, nr. 2008/19 dhe 2008/29, dhe ajo u bë përfundimisht më 30 qershor 2008 (shih Neni A.1. të këtij mendimi). Prandaj, duket se vetëm nga ajo kohë Dhoma e Posaçme e mori autoritetin për t'i shqyrtuar ankesat e ndërlidhura, siç është kjo

çështje, për dështim të AKM-së për të vepruar në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut 2005/48.

104. Për sa i përket periudhës prej 1 korrikut deri më 9 dhjetor 2008 (fundi i autoritetit të UNMIK-ut mbi gjyqësinë në Kosovë), Paneli rikujton që AKM-ja tanimë ishte tërhequr nga funksionet e veta administrative deri atëherë, dhe se ato ishin marrë përsipër nga AKP-ja. Në të njëjtën kohë, UNMIK-u po përgatitej t'i dorëzojë kompetencat e veta të plota ekzekutive tek EULEX-i. Paneli e pranon se, në parim, amendamenti i lartpërmendur në Rregulloren e UNMIK-ut 2002/13 krijoi një mundësi për t'u ankuar kundër AKM-së, nëse ajo vepron në mënyrë jo të duhur në ushtrimin e funksioneve të veta sipas Rregullores së UNMIK-ut 2005/48. Megjithatë, Rregullorja e fundit vlen vetëm për AKM-në, ndërsa AKP-ja madje nuk është përmendur. Megjithëse mundësia e paraqitjes së një ankese kundër AKP-së në DHPGJS mund të ishte sqaruar në Rregulloren 2008/4 (dhe më pas 2008/19), kjo nuk ndodhi.

105. Prandaj, sipas mendimit të Panelit, legjislacioni i UNMIK-ut në atë kohë ofroi një bazë për një ankesë kundër AKM-së, vetëm pasi u bë e ditur se ajo në fakt nuk ushtronte më funksionin e vet. Në anën tjetër, nuk u krijua asnjë mundësi për t'u ankuar kundër AKP-së deri në fund të juridiksionit të përkohshëm të Panelit.

106. Në të vërtetë, Paneli thekson se *Ligji për Agjencinë Kosovare të Privatizimit* (nr. 03/L-067), i cili sqaroi se AKP-ja është pasardhëse e AKM-së (Neni 5), është miratuar nga autoritetet e Kosovës në maj të vitit 2008. Megjithatë, vetëm në gusht të vitit 2011 *Ligji i ri për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që ndërlidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit* (nr. 04/L-033) i miratuar nga autoritetet e Kosovës, përfundimisht sqaroi se DHPGJS (e krijuar nën autoritetin e institucioneve lokale) kishte juridiksion t'i shqyrtojë ankesat kundër AKM-së dhe AKP-së në lidhje me "procedurat që dalin nën apo në kuadër të fushëveprimit të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2005/48 apo ndonjë legjislacion trashëgues për atë, apo një ankesë, çështje apo procedurë që del në një rast apo e ndërlidhur me një rast nën apo në kuadër të fushëveprimit të rregullores apo legjislacionit të tillë" (Nenet nr. 1.10. dhe 69).

107. Përveç kësaj, Paneli rikujton në këtë kontekst ankesat e paraqitura para tij nga dy persona juridikë serbë, Agjencia për Sigurimin e Depozitave e Serbisë dhe Banka "Jugobanka" të përfaqësuar nga ekipet e tyre të avokatëve. Ato, po ashtu, u ankuan në Panel rreth dështimit të AKM-së dhe DHPGJS-ë për ankesat e tyre të paraqitura në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut 2005/48 (shih vendimet e PKDNJ-së në rastet *AGJENCIA E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE* dhe *Jugobanka A.D. nën likuidim I* dhe *II* përmendur në § 83 më lart). Në parashtresat e tyre, asnjëra nga to nuk iu referua mundësisë për të paraqitur një ankesë kundër AKM-së, duke respektuar procedurën e riorganizimit sipas Rregullores së UNMIK-ut 2005/48, në DHPGJS. Sipas mendimit të Panelit, pasi ekipet ligjore të këtyre dy ankuesve të përbashkët, me sa duket nuk ishin në dijeni për një mjet të tillë juridik, nuk mund të pritej arsyeshëm se ankuesit në këtë rast madje ishin në dijeni për një mundësi të tillë.

108. Paneli, po ashtu, rikujton deklaratën e PSSP-së se AKM-ja kishte qenë dhe vazhdon të jetë autoritet i përgjithshëm për Kombinatin Trepça (shih § 30 më lart). Sipas mendimit të Panelit, kjo e shton konfuzionin sa i përket legjislacionit të aplikueshëm, autoritetit për ta menaxhuar Trepçën dhe më pas organit relevant për t'u ankuar kundër. Kjo e gjitha e mbështet mendimin e Panelit se nuk kishte mjet të qartë dhe efektiv juridik kundrejt

situatës së mungesës së qasjes në gjykatë, në të cilën ankuesit, si dhe shumë kreditorë tjerë të Kombinatit Trepça, ishin gjendur.

109. Prandaj, Paneli konsideron se, meqë moratoriumi plotësisht u mohoi ankuesve mundësinë t'i kenë të zgjidhura ankesat e tyre nga ndonjë gjykatë (duke përfshirë DHPGJS-ë) apo nga një mekanizëm jashtë procedurës së AKM-së, nuk ekzistoi asnjë mjet juridik efektiv kundër një mase të tillë që bllokonte qasjen e tyre në një gjykatë deri në fund të juridiksionit të përkohshëm të Panelit.

110. Prandaj, Paneli konstaton se kishte shkelje të nenit 13, në lidhje me nenin 6 § 1 të KEDNJ-së.

E. Shkelja e pretenduar e nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së

111. Paneli konsideron se në këtë pjesë të ankesës ankuesit pohuan në esencë se, për shkak të pamundësisë së tyre për t'i pasur të zgjidhura pretendimet e tyre materiale para AKM-së, ata nuk ishin në gjendje të pranojnë retroaktivisht pagesën e pagave të tyre që mbetën të papaguara nga koha që ata u detyruan t'i lënë vendet e tyre të punës. Ankuesit ankohen më tutje për dështimin e UNMIK-ut për të zgjidhur situatën e largimit të tyre nga vendet e tyre të punës dhe për mosmarrjen e pagave të tyre që nga qershori i vitit 1999.

112. Duke pasur parasysh shqyrtimet dhe të gjeturat e mësipërme, Paneli nuk sheh asnjë arsye për të shqyrtuar ndaras këtë pjesë të ankesës.

F. Shkelja e pretenduar e të drejtës për sigurim social dhe të drejtës për standard adekuat të jetesës

113. Ata që në mesin e ankuesve nuk i plotësuan kushtet e skemës për pensionim të parakohshëm pohojnë që, pasi ata janë larguar nga vendet e tyre të punës në qershor të vitit 1999, ata nuk kanë pranuar ndonjë pagesë të rregullt për të qenit tepricë apo pagesë për papunësinë, përveç pagesave të rastit *ex gratia* nga Administrata e Trepçës, për të mbështetur veten dhe familjet e tyre. Në lidhje me këtë, Paneli gjeti se kjo pjesë e ankesës duhet të shqyrtohet sipas nenit 9 (e drejta për sigurim social) dhe 11 (e drejta për standard adekuat të jetesës) e KNDESK-së për dështim të pretenduar të UNMIK-ut për të krijuar skemë alternative të mbështetjes për këtë kategori të punëtorëve joaktivë.

a. Parimet e përgjithshme

114. Të dyja, e drejta për standard adekuat të jetesës dhe e drejta për sigurim social janë përfshirë në Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut (DUDNJ) në të cilën thuhet se "secili, si anëtar i shoqërisë, e ka të drejtën për sigurim social" (Neni 22, DUDNJ) dhe që "secili e ka të drejtën për një standard të jetesës që është adekuat për shëndetin dhe mirëqenien e vetes dhe familjes së tij, duke përfshirë ushqimin, veshjen, strehimin dhe përkujdesjen mjekësore dhe shërbimet e nevojshme sociale, dhe të drejtën për sigurim në rast të papunësisë, sëmundjes, paaftësisë, të qenit i vejë, moshës së shtyrë apo mungesës tjetër të mjeteve të jetesës në rrethanat jashtë kontrollit të tij" (Neni 25.1, DUDNJ).

115. E drejta për sigurim social dhe e drejta për standard adekuat të jetesës, po ashtu, garantohen në KNDESK, në të cilën në pjesët relevante thuhet:

Neni 9

"Palët shtetërore në Konventën aktuale njohin të drejtën e secilit për siguri sociale, duke përfshirë sigurimin social".

Neni 11.1

"Palët shtetërore në Konventën aktuale njohin të drejtën e secilit për një standard adekuat të jetesës për veten dhe familjen e tij, duke përfshirë ushqimin, veshjen dhe strehimin adekuat, dhe përmirësimin e vazhdueshëm të kushteve të jetesës. Palët shtetërore do të ndërmarrin hapat e duhur për të siguruar realizimin e kësaj të drejte, duke njohur për këtë qëllim rëndësinë esenciale të bashkëpunimit ndërkombëtar …"

116. Paneli thekson se e drejta për sigurim social ishte afirmuar fuqishëm në të drejtën ndërkombëtare, duke u materializuar në disa traktate ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, duke përfshirë Konventën Ndërkombëtare kundër Të Gjitha Formave të Diskriminimit Racial (Neni 5 (e) (iv), Konventa për Eliminimin e Të Gjitha Formave të Diskriminimit Kundër Grave (Neni 11 dhe 14) dhe Konventa për të Drejtat e Fëmijëve (Neni 26) dhe traktatet e ILO-s (ONP-së).

117. Në Komentin e vet të përgjithshëm nr. 19 mbi të Drejtën për Sigurim Social (Neni 9), Komiteti i KNDESK-së kishte formuluar veçoritë kryesore të kësaj të drejte dhe fushëveprimin e obligimeve të palëve shtetërore sipas Konventës. E drejta për sigurim social kërkon krijimin e një sistemi, pavarësisht nëse përbëhet nga një skemë e vetme apo një varietet skemash, në dispozicion dhe në vend për të siguruar që përfitimet ofrohen për rreziqet relevante sociale dhe të papriturat, veçanërisht ato që rezultojnë nga rrethanat jashtë kontrollit të njerëzve. Një sistem i tillë duhet të krijohet "sipas ligjit vendor, dhe autoritetet publike duhet të marrin përgjegjësinë për administrim dhe mbikëqyrje efektive të sistemit" (në § 40). Nëntë fushat kryesore të sigurimit social parashihen me nenin 9 për të zëvendësuar apo rikthyer të hyrat e humbura që ndërlidhen me punën për shkak të "sëmundjes, paaftësisë, lindjes, lëndimit në punë, papunësisë, moshës së shtyrë apo vdekjes së një anëtari të familjes, qasje të papërballueshme në përkujdesje shëndetësore apo mbështetje e pamjaftueshme familjare (në § 11) …".

118. Komiteti ka theksuar më tutje se e drejta për sigurim social, si çdo e drejtë e njeriut, ua ngarkon autoriteteve shtetërore obligimin për ta respektuar, mbrojtur dhe përmbushur atë. Obligimi për ta respektuar kërkon që palët shtetërore për shembull të përmbahen nga përfshirja në një praktikë apo aktivitetet që "mohon apo kufizon qasje të barabartë në sigurim adekuat social". Obligimi për ta mbrojtur kërkon që palët shtetërore të parandalojnë palët e treta (individët, grupet, korporatat dhe entitetet e tjera, si dhe agjentët që veprojnë nën autoritetin e tyre) të interferojnë në çfarëdo mënyre në gëzimin e të drejtës për sigurim social. Ky obligim përfshin, "miratimin e masave të nevojshme dhe efektive legjislative dhe masave tjera, për shembull, për të kufizuar palët e treta të mohojnë qasje të barabartë në skemat e sigurimit social të drejtuara nga to apo të tjerët" (në § 45). Në fund, obligimi për ta përmbushur kërkon miratimin e të gjitha masave të nevojshme drejt realizimit të plotë të të drejtës për sigurim social, në mesin e tyre siç është thënë "njohje të mjaftueshme të kësaj të drejte në kuadër të sistemeve nacionale politike dhe ligjore, nëse është e mundshme me anën e implementimit legjislativ; miratimin e një strategjie nacionale dhe sociale të sigurimit dhe planit të veprimit për të realizuar këtë të drejtë".

119. Për sa i përket mbrojtjes sociale kundrejt papunësisë, Komiteti ka konsideruar që, "përveç promovimit të punësimit të punësimit të plotë, produktiv dhe të përzgjedhur lirisht, palët

shtetërore duhet bërë përpjekje të ofrojnë përfitime për të mbuluar humbjen apo mungesën e fitimeve për shkak të pamundësisë për të fituar apo pasur punësim të përshtatshëm". Në veçanti në rastin e humbjes së punësimit, "përfitimet duhet të paguhen për një periudhë adekuate të kohës dhe në kohën e skadimit të periudhës, sistemi i sigurimit social duhet të sigurojë mbrojtje adekuate të punëtorit të papunë, për shembull përmes asistencës sociale". Veç kësaj, "përfitime duhet siguruar për të mbuluar periudhat e humbjes së fitimeve nga personat të cilëve u është kërkuar të mos raportojnë për punën gjatë një emergjence të shëndetit publik apo emergjence tjetër" (në § 16). Gjatë marrjes në konsideratë të raporteve të palëve shtetërore sipas Konventës, Komiteti shprehu qëndrimin se mungesa e përfitimeve në rastin e papunësisë "shkon kundër obligimeve të palës shtetërore"[11] sipas KNDESK-së. Megjithatë nuk janë specifikuar në KNDESK apo nga Komiteti shumat minimale të përfitimeve të tilla, apo gjatësia minimale e kohëzgjatjes së tyre.

120. Komiteti i KNDESK-së ka theksuar që "sigurimi social është i një rëndësie kryesore për garantimin e një jete me dinjitet", duke nënvizuar marrëdhënien në mes të kësaj të drejte dhe realizimit të të drejtave tjera ekonomike, sociale dhe të drejtave të njeriut, kryesisht të drejtës për një standard adekuat të jetesës dhe të drejtës në shëndet. Në lidhje me këtë, për sa i përket parimit për dinjitet njerëzor që përmban preambula e Konventës, është vendosur mirë se, përfitimet pensionale në para të gatshme apo të mira materiale, dhe përveç të qenit në dispozicion, të qasshme dhe të përballueshme, duhet të jenë adekuate "në shumë dhe kohëzgjatje me qëllim që secili të mund t'i realizojë të drejtat e tij/saj për mbrojtje dhe asistencë sociale, një standard adekuat të jetesës dhe qasje adekuate në përkujdesje shëndetësore". Veç kësaj, kriteret e të qenit adekuat duhet të monitorohen rregullisht për të siguruar që përfituesit janë në gjendje t'ia ofrojnë vetes të mirat dhe shërbimet që ata i kërkojnë për të realizuar të drejtat e tyre sipas Konventës.

121. Pranohet se, në pajtim me nenin 2 të KNDESK-së, i cili ka të bëjë me fushëveprimin e obligimeve shtetërore sipas Konventës, realizimi i plotë i të drejtës për sigurim social dhe të drejtës për standard adekuat të jetës mund të arrihet vetëm "progresivisht", deri në maksimumin e burimeve në dispozicion të shteteve. Megjithatë, është e kuptueshme se këto dispozita të KNDESK-së, po ashtu, ngarkojnë obligime të cilat janë të efektit të menjëhershëm. Këto përfshijnë: obligimin për të garantuar që ushtrimi i këtyre të drejtave duhet të jetë i lirë nga diskriminimi dhe të sigurohet së paku gëzimi "i niveleve minimale esenciale" të secilës nga të drejtat në fjalë.

122. Ky obligimi i fundit, në lidhje me të drejtën për sigurim social, kërkon sigurimin e qasjes në një skemë të sigurimit social që ofron "një nivel minimal të përfitimeve për të gjithë individët dhe familjet që u mundësojnë atyre të kenë së paku përkujdesjen esenciale shëndetësore, strehë dhe banim me kushte elementare, ujë dhe instalime hidrosanitare, gjëra ushqimore dhe format më elementare të arsimimit".

123. Komiteti ka theksuar se obligimet bazë minimale të cekura më lart, vlejnë "po ashtu në kohë të kufizimeve të mëdha në burime", ku autoritetet kanë obligime për t'i mbrojtur "anëtarët e cenueshëm të shoqërisë" (Komiteti i KNDESK-së, Komenti i përgjithshëm nr. 3 *mbi Llojin e Obligimeve të Palëve Shtetërore*, në § 12)[12]. Veç kësaj, vëmendje e veçantë duhet pasur për të siguruar që një sistem i sigurimit social të mund t'u përgjigjet

[11] Shih: Komiteti për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, Observime përfundimtare: Siri, Dok. i OKB-së E/C.12/1/Add.63, 24 shtator 2001, në § 22.
[12] Komiteti i KNDESK-së, Komenti i përgjithshëm nr. 3 mbi Llojin e obligimeve të palëve shtetërore, 14 dhjetor 1990, Dok. i OKB-së E/1991/23, në § 12.

kohëve të emergjencës, sikur gjatë dhe pas fatkeqësive të natyrës, konfliktit të armatosur apo dështimit në të mbjella. Me qëllim që autoritetet të shmangin përgjegjësinë për dështimin për të përmbushur së paku obligimet minimale bazike, ato duhet të demonstrojnë se të gjitha përpjekjet janë bërë për të përdorur të gjitha burimet që janë në dispozicion të tyre për të përmbushur, si çështje prioriteti, këto obligime minimale bazike.

b. Aplikimi i parimeve të përgjithshme në rastin aktual

124. Në fillim, Paneli thekson se kjo pjesë e ankesës kufizohet në ata ankues të cilët nuk përmbushën kriteret e parapara për t'u regjistruar në skemën e pensionimit të parakohshëm të krijuar nga UNMIK-u në përkrahje të fuqisë punëtore të Trepçës të cilët ishin bërë të tepërt. Ankuesit pohojnë se nuk u ishte vënë në dispozicion atyre asnjë skemë alternative mbështetëse për t'i përkrahur ata në situatat e befasishme dhe të papritura të mospunësimit dhe që ata janë lënë pa mjete për përkrahje të vetes dhe familjeve të tyre.

125. Në kundërshtim me parashtresat e PSSP-së siç janë përmbledhur në §§ 60-62 më lart, sipas të cilave ankuesit pohojnë për shkelje nga UNMIK-u të një të "drejte të fituar në pronë" të mbrojtur me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, Paneli, siç ka theksuar në fazën e pranueshmërisë, konsideron se kjo pjesë e ankesës ka të bëjë me obligimet e UNMIK-ut sipas nenit 9 (e drejta në sigurim social, në veçanti kundrejt papunësisë) dhe 11 (e drejta për standard adekuat të jetesës) e KNDESK-së. Prandaj, ajo i bie se duhet shqyrtuar sipas këtyre dispozitave.

126. Paneli thekson se nuk mund të ketë asnjë dyshim rreth përgjegjësisë së UNMIK-ut për të garantuar të drejtat e ankuesve siç sigurohen me nenet 9 dhe 11 të KNDESK-së. Paneli thekson se që nga qershori i vitit 1999, UNMIK-u mori mbi vete autoritetin e përgjithshëm legjislativ dhe ekzekutiv në Kosovë, që përfshinte përgjegjësinë për të krijuar kornizën institucionale dhe rregulluese për riorganizimin dhe/apo likuidimin e ndërmarrjeve publike, një detyrë që filloi në vitin 2002. Paneli po ashtu thekson që, ndërsa e kryente këtë detyrë komplekse, UNMIK-u e kishte përgjegjësinë t'i marrë masat e nevojshme të sigurisë sociale për të mbrojtur të drejtat e njeriut, duke përfshirë të drejtat ekonomike dhe sociale, të banorëve të Kosovës, e cila ishte në esencë të mandatit të UNMIK-ut në pajtim me Rezolutën e Këshillit të Sigurimit të OKB-së 1244 (1999).

127. Paneli thekson se, pavarësisht rrethanave specifike dhe përgjegjësisë për largimin e tyre nga puna në Minierat e Kishnicës në qershor të vitit 1999 (shih PKDNJ, *Punëtorët e Minierave Kishnicë dhe Novobërdë të Kombinatit Trepça*, nr. 81/10, vendimi i 14 prillit të vitit 2014, §§ 43-48), të cilat janë jashtë juridiksionit të vet *ratione temporis*, ankuesit ishin lënë pas kësaj, në fakt, pa punë dhe pa rroga. Paneli thekson që, së paku prej vitit 2002, kjo situatë vazhdoi me dijen dhe pranimin e heshtur të UNMIK-ut. Që nga ajo kohë Minierat e Kishnicës si pjesë e Kombinatit Trepça janë vendosur nën administrim të AKM-së, një organ i UNMIK-ut.

128. Paneli thekson më tutje se UNMIK-u ishte në dijeni për situatën e cenueshme të atyre punëtorëve të Trepçës të cilët ishin bërë tepricë teknologjike, siç dëshmohet po ashtu nga masat e miratuara nga ai drejtpërdrejt apo me ndihmën e tij me qëllim të ofrimit atyre një formë të mbështetjes për siguri sociale.

129. Paneli po ashtu thekson se, në bazë të një programi të regjistrimit, trajnimit dhe shkurtimit të punëtorëve të Trepçës të realizuar nga IOM-i në vitin 2001-2002, prej vitit 2003 UNMIK-u krijoi në vazhdim një skemë për pensionim të parakohshëm për ata

punëtorë joaktivë të moshës 50-65 që përmbushnin kërkesat shtesë të parapara me Udhëzimin Administrativ të UNMIK-ut nr. 3/2003, siç është modifikuar më vonë me Udhëzimin Administrativ të UNMIK-ut nr. 02/2006 të muajit mars të vitit 2006. Pasi që punëtorët që zgjodhën skemën arrijnë moshën e caktuar, ata bëhen ish-punëtorë të ndërmarrjes dhe marrin 40 euro në muaj si pension i parakohshëm. Skema ishte paraparë si masë e përkohshme derisa punëtorët në fjalë arrijnë moshën e pensionimit të rregullt, në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2001/35 të 22 dhjetorit të vitit 2001 *mbi Pensionet në Kosovë*, e cila vendosi një sistem të ri pensionimi në Kosovë, funksional që nga viti 2002.

130. Ankuesit që nuk plotësonin kushtet për marrjen e pensionit të parakohshëm, apo të cilët zgjodhën të mos regjistrohen në skemë, ankohen se ata nuk pranuan ndonjë formë të rregullt të përkrahjes financiare (p.sh. përfitim për të qenit tepricë teknologjike apo i papunë), e cila ua bëri atyre dhe familjeve të tyre të vështirë të kenë një standard adekuat të jetesës. Ata u ankuan se UNMIK-u nuk kishte krijuar skemë alternative mbështetjeje për punëtorët në gjendjen e tyre. Në fazën e pranueshmërisë, Paneli e shpalli këtë pjesë të ankesës të pranueshme, duke u bazuar në parashtresat e ankuesve, që nuk u kontestuan nga PSSP-ja.

131. Megjithatë, në dritë të informatave shtesë të mbledhura më pas nga Paneli, del se një skemë shtesë e përkrahjes që përbëhej nga "pagesa" mujore për ata punëtorë joaktivë të Kombinatit Trepça nën moshën për pensionim të parakohshëm apo të rregullt, ishte krijuar vërtet nga Trepça nën administrim të UNMIK-ut/AKM në bashkëpunim me IPVQ-të, që nga viti 2004. Paneli mbështetet në informatat e marra nga palët, si dhe dokumentet në fushën publike, në të cilat thuhet se një numër i madh i punëtorëve të Kombinatit Trepça që nuk ishin të kualifikuar për pensionim kanë pranuar një shumë mujore për të qenit tepricë teknologjike prej 50 eurosh, të financuar pjesërisht nga buxheti i Trepçës nën administrim të UNMIK-ut dhe pjesërisht nga BKK-ja.

132. Paneli thekson që kjo ishte situata në fillim të juridiksionit të përkohshëm te Panelit më 23 prill 2005. Paneli thekson se me këtë datë, skema për pensionim të parakohshëm ishte në vazhdim e sipër, me ish-punëtorë shtesë që regjistroheshin progresivisht pasi ata arrinin moshën 50 vjeç, ndërsa "pagesa" mujore apo përfitimet për të qenit tepricë teknologjike u paguheshin një numri të madh të punëtorëve joaktivë nën moshën për pensionim të parakohshëm. Paneli, po ashtu, thekson që të dyja marrëveshjet vazhduan të jenë në fuqi gjatë gjithë kohës që UNMIK-u ushtroi kompetencat e plota ekzekutive në Kosovë (qershor 2008), dhe në fushën e drejtësisë (dhjetor 2008), data të cilat, po ashtu, shënojnë fundin e juridiksionit të përkohshëm të Panelit.

133. Për sa i përket pretendimit të ankuesve, që nuk kundërshtohet nga PSSP-ja, që atyre nuk u janë paguar përfitimet për të qenit tepricë teknologjike të përmendura më lart, Paneli ka kërkuar informata nga të cilat del se, në të vërtetë jo të gjithë punëtorët joaktivë nën moshën për pensionim të parakohshëm kanë marrë të ashtuquajturat "pagesa". Për shembull, Paneli thekson se në Raportin vjetor të vitit 2010 të AKP-se thuhet që, në vitin 2006, nga 9400 persona të regjistruar si (ish) punëtorë të Trepçës, një total prej 5,700 pranonin përfitimet për sigurime sociale (3400 pensione të parakohshme dhe 2,300

"pagesa")[13]. Ngjashëm, sipas Raportit të Auditimit të Qeverisë së Kosovës për vitin 2012, "pagesa" e Trepçës për vitin e njëjtë ishin 199 në jug dhe 1883 në veri të Kosovës[14].

134. Megjithatë, dhe pavarësisht nga kërkimi i informatave të shumta duke përfshirë UNMIK-un dhe MPMS-në e Kosovës, Paneli nuk mundi të gjente ndonjë dokument (ligj, udhëzim administrativ, vendim të qeverisë apo ngjashëm) që vendos kriteret e të qenit i kualifikuar, shumën dhe kohëzgjatjen e këtyre përfitimeve, të cilat do të justifikonin përjashtimin e ankuesve nga shpërndarja e tyre. Panelit i duket se, sapo ishte krijuar, implementimi i sistemit të pagesave u ishte lënë degëve të Administratave të Trepçës (Veri dhe Jug) dhe, deri në një nivel, sindikatave të punëtorëve.

135. Ndërsa pranon përpjekjet e UNMIK-ut, drejtpërdrejt dhe përmes organit të vet AKM-së, për të ofruar një rrjet të sigurimit social për punëtorët e ndërmarrjes të cilët kishin mbetur tepricë teknologjike, Paneli thekson se administrimi praktik i përfitimeve mujore për të qenit tepricë teknologjike, i cili nuk ishte përkrahur nga një kornizë e qartë ligjore dhe rregulluese, ishte i tillë që krijonte hapësirë për keqpërdorim të sistemit nga palët e treta dhe përjashtimin e padrejtë pasues të përfituesve të mundshëm siç janë ankuesit. Paneli thekson se shqetësimi për mungesën e rregullores mbi menaxhimin e pagesave ishte ngritur po ashtu nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës, e cila thoshte se mungesa e bazës ligjore për këtë skemë ka rritur parregullsitë (shih § 21 më lart). Në lidhje me këtë, Paneli u referohet qëndrimeve të shprehura nga Komiteti i KNDESK-së se një aspekt thelbësor i obligimeve të autoriteteve për të mbrojtur gëzimin efektiv të të drejtës për sigurim social është të miratohen ato masa të nevojshme legjislative dhe masa tjera për t'i parandaluar palët e treta nga të mohuarit e qasjes në skema të sigurimit social.

136. Megjithatë, Paneli vëren se në rastin aktual, pavarësisht nevojës së identifikuar nga UNMIK-u për të krijuar një sistem të përfitimeve për të qenit tepricë teknologjike për punëtorët joaktivë të Trepçës në pritje të riorganizimit të ndërmarrjes, nuk ishte miratuar asnjë masë legjislative apo rregulluese nga UNMIK-u për të krijuar një sistem që ofronte kritere objektive për të qenit i kualifikuar dhe modalitete të shpërndarjes së përfitimeve të lartpërmendura, si dhe sigurimin e mjeteve juridike në rast të implementimit të gabuar të sistemit. Paneli po ashtu thekson që, në kontekst të "obligimeve minimale bazike", të cilat u kërkohet autoriteteve shtetërore t'i përmbushin menjëherë sipas Konventës, UNMIK-u nuk ka paraqitur ndonjë të dhënë se i kishte përdorur të gjitha burimet e veta në dispozicion për të përmbushur objektivin e rregullimit me ligj të shpërndarjes së përfitimeve për të qenit tepricë teknologjike të punëtorëve të Trepçës. Përkundrazi, UNMIK-u nuk ka dhënë ndonjë sqarim për të justifikuar dështimin e tillë për të vënë në vend ndonjë sistem të tillë.

137. Paneli, po ashtu, thekson parashtresat e ankuesve se ata iu drejtuan disa institucioneve në Kosovë, duke përfshirë Administratën e Trepçës dhe organet e UNMIK-ut, me qëllim që të ankohen rreth kësaj situate (shih § 35 më lart), por pa dobi.

138. Në lidhje me këtë, Paneli konsideron se UNMIK-u, si administrator i përkohshëm i Trepçës, si dhe administrator i përkohshëm i Kosovës dështoi t'i përmbushë obligimet e veta sipas nenit 9 të KNDESK-së. Në veçanti, Paneli konsideron se dështimi i UNMIK-ut të krijojë një kornizë të qartë ligjore për krijimin, monitorimin dhe implementimin e

---

[13] Raporti vjetor i AKP-së, janar – dhjetor 2010, f. 17 // Në dispozicion në [burimi elektronik] http://www.pak-ks.org/repository/docs/raporti_anglisht_FINAL.pdf (i qasur më 14 maj 2016).

[14] Raporti *mbi pasqyrat financiare të Ndërmarrjes Shoqërore Trepça për Vitin që përfundoi më 31 dhjetor 2012*, përmendur në fusnotën 5 më lart, në f. 27 dhe 47.

sistemit të pagesave kishte si rrjedhojë një përjashtim të padrejtë të ankuesve nga skemat e lartpërmendura dhe paraqiti shkelje të të drejtës së tyre për siguri sociale. Pasi ankuesit ishin lënë pa mjete për të mbështetur veten dhe familjet e tyre, Paneli po ashtu konsideron se e drejta e tyre për standard adekuat të jetesës, po ashtu, ishte shkelur.

139. Më pas Paneli konstaton shkelje të neneve 9 dhe 11 të KNDESK-së.

G. Shkelja e pretenduar e nenit 2, në lidhje me nenet 9 dhe 11 të KNDESK-së

140. Duke pasur parasysh se ankuesit ankohen që, me largimin e tyre nga puna, kushte më shumë të favorshme për mirëqenie ishin ofruar për ata punëtorë (joaktivë) të Minierave të Kishnicës me etni shqiptare, Paneli konsideron se kjo pjesë e ankesës i bie të shqyrtohet sipas nenit 2, marrë në lidhje me nenet 9 (e drejta në sigurim social) dhe 11 (e drejta për standard adekuat të jetesës) e KNDESK-së.

141. Paneli rikujton që mosdiskriminimi dhe barazia janë komponentë fundamentale të të drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe se ndalimi i diskriminimit arsyetohet nga Karta e Organizatës së Kombeve të Bashkuara dhe është vendosur në të gjitha instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, duke filluar me Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut (nenet 2 dhe 7). Për sa i përket të drejtave ekonomike dhe sociale, në nenin 2.2 të KNDESK-së ceket se obligimi i palëve shtetërore për të garantuar të drejtat e shpallura në Konventë "do të vlejë pa diskriminim të ndonjë lloji sa i përket racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, religjionit, mendimit politik apo mendimit tjetër, origjinës nacionale apo sociale, pronës, lindjes apo statusi tjetër".

142. Ndalimi i diskriminimit sipas nenit 2.2 përfshin të dyja format direkte dhe indirekte të trajtimit të ndryshëm. Diskriminimi i drejtpërdrejtë ndodh "kur një person trajtohet në mënyrë më pak të favorshme se personi tjetër në një situatë të ngjashme për një arsye që ndërlidhet me një bazë të ndaluar", veç nëse justifikimi për diferencim është "i arsyeshëm dhe objektiv". Diskriminimi indirekt u referohet "ligjeve, politikave apo praktikave të cilat duken neutrale në aspektin sipërfaqësor, por kanë një ndikim joproporcional në shfrytëzimin e të drejtave të Konventës ndërsa dallohet nga bazat e ndaluara të diskriminimit"[15].

143. Siç thuhet nga Komiteti për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, në kontrast me obligimet e ngarkuara për shtetet nga neni 2.1 i KNDESK-së, të cilat kryesisht i nënshtrohen realizimit progresiv, neni 2.2 ngarkon obligimin konkret dhe të menjëhershëm për të garantuar që të drejtat e Konventës shfrytëzohen pa diskriminim[16]. Komiteti, po ashtu, ka theksuar që një "dështim për të mënjanuar trajtimin e ndryshëm duke u bazuar në mungesën e burimeve në dispozicion nuk është justifikim objektiv dhe i arsyeshëm, veç nëse është bërë çdo përpjekje për t'i përdorur të gjitha burimet që janë në dispozicion të palës shtetërore në përpjekje për të trajtuar dhe eliminuar diskriminimin, si një çështje prioritare"[17].

---

[15] Komiteti i KNDESK-së, Komenti i përgjithshëm nr. 20 *Mosdiskriminimi në të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore* (neni. 2, para. 2, i Konventës), 2 korrik 2009, Dok. i OKB-së E/C.12/GC/20, në §§ 10 dhe 13. Shih gjithashtu GJEDNJ [DHL], *D.H. dhe të tjerët kundër Republikës Çeke*, nr. 57325/00, vendimi i 13 nëntorit të vitit 2007, § 175 dhe rastet e përmendura aty.

[16] Komiteti i KNDESK-së, Komenti i përgjithshëm nr. 3 përmendur në fusnotën 12 më lart, në § 10; dhe Komenti i përgjithshëm nr. 20 përmendur në fusnotën 15 më lart, në §7.

[17] *Ibid*., në § 13.

144. Për sa i përket shtrirjes së obligimeve të palëve shtetërore, Paneli thekson se sipas nenit 2.2. atyre u kërkohet të marrin masa konkrete, të paramenduara dhe që kanë një qëllim, duke përfshirë masat legjislative, për të eliminuar diskriminimin, si dhe për të vlerësuar rregullisht nëse masat e përzgjedhura janë efektive në praktikë[18]. Palët shtetërore duhet të ofrojnë strategjitë, politikat dhe planet e veprimit që janë në vend dhe të implementueshme për të trajtuar diskriminimin nga të dyja palët publike dhe private në fushën e të drejtave ekonomike dhe sociale. Në veçanti "politikat ekonomike, sikur ndarja e buxhetit dhe masat për të stimuluar zhvillimin ekonomik, duhet t'i kushtojnë vëmendje nevojës për të garantuar shfrytëzim efektiv të të drejtave të Konventës pa diskriminim"[19].

145. Masat kundër diskriminimit duhet të përfshijnë dispozitat për mekanizmat dhe institucionet (p.sh. gjykatat, tribunalet, autoritetet administrative, institucionet nacionale për të drejtat e njeriut) që merren me shkeljet e pretenduara të nenit 2.2., duke përfshirë aktet apo lëshimet nga palët private, të cilat duhet të jenë të qasshme për secilin[20]. Lidhur me çështjen e peshës së dëshmisë në rastet ku diskriminimi është pretenduar, Komiteti ka theksuar që, "ku faktet dhe ngjarjet në fjalë bien plotësisht, apo pjesërisht, brenda dijes ekskluzive të autoriteteve apo palës tjetër të paditur, pesha e dëshmisë duhet vlerësuar se qëndron mbi autoritetet, apo palën tjetër të paditur"[21].

146. Duke iu kthyer rastit të ankuesve, Paneli thekson se ata në esencë ankohen se, me largimin e tyre nga puna, ata nuk kanë marrë përfitimet e njëjta financiare që u janë dhënë punëtorëve shqiptarë të Kombinatit Trepça, duke përfshirë Minierat e Kishnicës, të cilët ishin në të njëjtën situatë faktike. Prandaj, ata ankohen se ishin të diskriminuar në shfrytëzimin e të drejtave të tyre për sigurim social dhe për standard adekuat të jetesës të bazuar në etninë e tyre, në shkelje të nenit 2.2 të KNDESK-së.

147. Duke u bazuar në parashtresat e ankuesve siç janë paraqitur në fazën e pranueshmërisë, të cilat nuk janë kundërshtuar nga PSSP-ja, Paneli vendosi që ankuesit kanë krijuar një rast *prima facie* të diskriminimit, i cili përligjte shqyrtimin e tij të mëtejmë për bazueshmërinë.

148. Duke u bazuar në informatat shtesë të mbledhura nga UNMIK-u, menaxhmenti i Trepçës, përfaqësuesi i ankuesve dhe MPMS e Kosovës, Paneli e bën vlerësimin vijues.

149. Derisa ankuesit ankohen se ata nuk mundën të regjistrohen në skemën e pensionimit të parakohshëm të krijuar nga UNMIK-u prej vitit 2003, Paneli rikujton se kjo skemë ishte krijuar me ligjet e miratuara nga Kuvendi i Kosovës dhe nxjerrë nga PSSP-ja, i cili vendosi kërkesat për caktimin e pensioneve të parakohshme për ish-punëtorët e Kombinatit Trepça. Duke i vlerësuar këto kërkesa, Paneli konsideron se ato ishin të bazuar në kritere të qarta dhe objektive, të cilat nuk diskriminonin punëtorët serbë *vis-à-vis* punëtorëve shqiptarë të Trepçës. Paneli, po ashtu, thekson se asnjë nga ligjet e lartpërmendura më lart nuk vendosi-së paku në periudhën nën juridiksionin e UNMIK-ut – rregulla të qarta neutrale për shfrytëzimin e pensioneve të parakohshme, të cilat në aplikimin e tyre praktik ishin të tilla që ndikonin joproporcionalisht te punëtorët me etni serbe, sikur ankuesit. Paneli thekson më tutje, sa i përket implementimit të skemës për pensionim të parakohshëm, se asnjëri nga ankuesit nuk paraqiti dëshmi *prima facie* se ata përmbushnin kërkesat për pranim të një pensioni të parakohshëm dhe megjithatë ishin

[18] Komiteti i KNDESK-së, Komenti i përgjithshëm nr. 20, përmendur në fusnotën 15 më lart, në § 36.
[19] *Ibid*., në § 38.
[20] Shih Komiteti i KNDESK-s, Komenti i përgjithshëm nr. 20 përmendur në fusnotën 15 më lart, në § 40.
[21] *Ibid*.

parandaluar ta merrnin atë në pajtim me ligjin. Për këtë arsye, Paneli konsideron se ankesat e tyre sipas nenit 2.2 të KNDESK-së janë të pabazuara.

150. Për sa i përket atyre ankuesve të cilët nuk plotësonin kushtet e moshës për pensionim të parakohshëm dhe të cilët ankohen se ata nuk i kanë pranuar përfitimet për papunësi që i kanë marrë kolegët e tyre shqiptarë, Paneli rikujton se nga informata në dispozicion të tij duket se, duke filluar nga viti 2004 dhe për krejt periudhën nën administrim të UNMIK-ut, një sistem i pageave mujore për punëtorët joaktivë të Trepçës ishte krijuar, me financim nga të dyja, buxheti i Trepçës (në shumën prej 30 eurosh në muaj) dhe BKK (në shumën prej 20 eurosh në muaj).

151. Ankuesit theksojnë se ata nuk i kanë pranuar këto pagesa mujore dhe se ata kanë pranuar vetëm pagesa jo të rregullta në shuma të paspecifikuara parash nga Administrata e Trepçës e vendosur në veri. Paneli thekson se kjo deklaratë nuk kontestohet nga PSSP-ja.

152. Paneli po ashtu thekson që, duke u bazuar në dokumentacionin e mbledhur, është e qartë se jo të gjithë punëtorët joaktivë të Trepçës kishin marrë pagesat mujore të përmendura më lart. Megjithatë, kriteret në bazë të cilave një numër i punëtorëve janë përjashtuar nga përfitimet për papunësi nuk janë të qarta, meqë, për keqardhje, asnjë pjesë e legjislacionit apo rregullore apo udhëzim, as nga Administrata e Trepçës e as nga UNMIK-u apo autoritetet lokale, nuk mund të gjendej e të cilat parashihet të krijojnë kriteret e të qenit i kualifikuar apo procedurën për shpërndarjen e atyre pagesave mujore. Paneli thekson që, kur është pyetur në këtë aspekt, PSSP/UNMIK-u konfirmuan se asnjë legjislacion nuk ekziston në lidhje me këtë.

153. Paneli konsideron se ishte përgjegjësi e UNMIK-ut, si administrator i Trepçës dhe si autoritet zëvendësues shtetëror në Kosovë, të sigurojë që sistemi për përfitime për papunësi i paraparë për punëtorët joaktivë të Kombinatit Trepça është themeluar dhe implementuar në pajtim me kritere të qarta dhe objektive në mënyrë ideale të cekura në ligje, udhëzime apo rregullore, për të shmangur çdo formë të përjashtimit diskriminues apo formë tjetër të abuzimit.

154. Në anën tjetër, Panelit nuk i janë paraqitur *dëshmi të mjaftueshme* prima *facie* për të gjykuar se sistemi i pagesave ishte implementuar në një mënyrë diskriminuese kundër ankuesve në bazë të etnisë së tyre, meqë Paneli ka përshtypjen se mungesa e legjislacionit dhe kritereve të përcaktuara për alokimin dhe shpërndarjen e përfitimeve mujore për papunësi mund t'i ketë prekur në mënyrë të barabartë punëtoret joaktivë të Kombinatit Trepça me etni shqiptare. Veç kësaj, Paneli thekson se, pavarësisht nga ekzistenca e kornizës ligjore kundër diskriminimit siç është parashtruar po ashtu nga PSSP-ja, ankuesit nuk kanë paraqitur ndonjë parashtresë apo dëshmi se ata kanë paraqitur ankesë te menaxhmenti i Trepçës, UNMIK-u apo autoritetet lokale se ata ishin përjashtuar padrejtësisht nga shfrytëzimi i përfitimeve për papunësi. Për këto arsye, Paneli gjen ankesën për diskriminim të pretenduar si të pabazuar po ashtu sa i përket këtij grupi të punëtorëve.

155. Në dritë të kësaj që u tha më lart, Paneli përfundon se nuk kishte shkelje të nenit 2.2, marrë në lidhje me nenin 9 dhe 11 të KNDESK-së.

V. REKOMANDIME

156. Në dritën e gjetjeve të Panelit në këtë rast, Paneli mendon se është e nevojshme ndonjë formë e dëmshpërblimit.

157. Do të ishte normale që UNMIK-u t'i marrë masat e duhura me qëllim që t'i ndalë shkeljet e gjetura dhe t'i korrigjojë aq sa është e mundshme efektet nga kjo. Paneli është i vetëdijshëm për faktin se që nga qershori i vitit 2008 shumica e përgjegjësive të UNMIK-ut sipas Rezolutës së KS të OKB-së 1244 si Administratë e Përkohshme në Kosovë ishin marrë përsipër nga autoritetet lokale (shih § 28 më lart) dhe që AKM-ja ndërpreu punën e vet (shih § 29 më lart). Pas asaj, përgjegjësia e tij në lidhje me drejtësinë në Kosovë përfundoi më 9 dhjetor 2008 (shih § 31 më lart). Prandaj, UNMIK-u nuk është më në pozitë të përshpejtojë drejtpërdrejt procedurat që janë në pritje në AKP (trashëguese e AKM-së) dhe para Dhomës së Posaçme.

158. Megjithatë, Paneli konsideron se kjo situatë faktike nuk e liron UNMIK-un nga obligimi i tij për t'i korrigjuar aq sa është e mundshme efektet e shkeljeve për të cilat është përgjegjës.

159. E para, Paneli konsideron se UNMIK-u duhet të pranojë publikisht, brenda një kohe të arsyeshme përgjegjësinë për shkeljet e përshkruara më lart dhe t'u kërkojë falje publike ankuesve në lidhje me këtë.

160. E dyta, duke rikujtuar pohimin e PSSP-së se AKM-ja ka qenë dhe vazhdon të jetë autoritet i përgjithshëm për Kombinatin Trepça (shih § 30 më lart), Paneli konsideron se UNMIK-u duhet të ushtrojë autoritetin e vet mbi Kombinatin Trepça dhe t'i marrë masat e duhura për të siguruar që ankuesit e kualifikuar për të pranuar pagesa të fillojnë sipas rregullit që të përfitojnë nga ajo skemë mbështetjeje.

161. Për arsyen e njëjtë, Paneli konsideron se UNMIK-u duhet të sigurojë që janë krijuar instrumentet e duhura ligjore që rregullojnë pagesat për punëtorët e Kombinatit Trepça dhe të bëhen publike pa vonesë.

162. Veç kësaj, në pajtim me praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në situatat me juridiksion të kufizuar të shtetit, Paneli është i mendimit se UNMIK-u duhet bërë përpjekje, me të gjitha mjetet në dispozicion të tij *vis-à-vis* autoriteteve kompetente të Kosovës, të marrë siguri që ankesat e dorëzuara nga ankuesit para AKM-së (dhe tani në pritje para AKP-së) janë shqyrtuar sipas rregullit (shih PKDNJ, *Millogoriq dhe të tjerët* § 49, përmendur në § 10 më lart; krahasoje me GJEDNJ [DHL], *Ilaşcu dhe të tjerët kundër Moldavisë dhe Rusisë*, nr. 48787/99, vendimi i 8 korrikut të vitit 2004, *KEDNJ*, 2004-VII, § 333; GJEDNJ, *Al-Saadoon dhe Mufdhi kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 61498/08, vendimi i 2 marsit të vitit 2010, § 171).

163. Në fund, Paneli konsideron se UNMIK-ut duhet të ndërmarrë hapa të duhur drejt pagesës së kompensimit adekuat ankuesve për dëmet që u janë shkaktuar si rezultat i shkeljeve të lartpërmendura.

PËR KËTO ARSYE,

Paneli, unanimisht,

1. **KONSTATON SE KA PASUR SHKELJE TË NENIT 6 § 1 TË KONVENTËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT PËR SA I PËRKET PAMUNDËSISË QË ANKUESIT TË KENË VENDIM PËR ANKESAT E TYRE;**

2. **KONSTATON SE KA PASUR SHKELJE TË NENIT 13 NË LIDHJE ME NENIN 6 § 1 TË KONVENTËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT PËR SA I PËRKET MUNGESËS SË NJË MJETI JURIDIK PËR ANKUESIT NË SITUATËN QË UA PARANDALONTE ATYRE TË KENË VENDIM PËR ANKESAT E TYRE NGA NJË GJYKATË;**

3. **KONSTATON SE NUK KA NEVOJË TË SHQYRTOHET ANKESA SIPAS NENIT 1 TË PROTOKOLLIT NR. 1 TË KONVENTËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT;**

4. **KONSTATON SE KA PASUR SHKELJE TË NENEVE 9 DHE 11 TË KONVENTËS NDËRKOMBËTARE PËR TË DREJTAT EKONOMIKE, SOCIALE DHE KULTURORE PËR SA I PËRKET MUNGESËS SË NDIHMËS MINIMALE BAZIKE PËR SIGURIM SOCIAL TË ANKUESVE CILËT NUK MERRNIN PENSIONET E PARAKOHSHME;**

5. **KONSTATON SE NUK KA PASUR SHKELJE TË TË DREJTAVE TË ANKUESVE TË GARANTUARA ME NENIN 2, NË LIDHJE ME NENET 9 DHE 11, TË KONVENTËS NDËRKOMBËTARE PËR TË DREJTAT EKONOMIKE, SOCIALE DHE KULTURORE.**

6. **REKOMANDON QË UNMIK-u:**

   a. **TË PRANOJË DËSHTIMIN E VET PËR TË PËRMBUSHUR OBLIGIMET SIPAS NENEVE 6 § 1 DHE 13 TË KONVENTËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT DHE NENEVE 9 DHE 11 TË KNDESK-së, DHE T'U KËRKOJË FALJE PUBLIKE ANKUESVE;**

   b. **T'U KËRKOJË AUTORITETEVE KOMPETENTE NË KOSOVË QË T'I NDËRMARRIN TË GJITHË HAPAT E MUNDSHËM ME QËLLIM TË SIGURIMIT QË TË VENDOSET PA NDONJË VONESË TË MËTEJSHME PËR ANKESAT E ANKUESVE PARA AKP-së PËR TË QENË I KUALIFIKUAR;**

   c. **TË SIGUROJË QË ANKUESIT QË JANË TË KUALIFIKUAR TË PRANOJNË PAGESA TË JENË TË PËRFSHIRË SIÇ DUHET NË LISTËN E PËRFITUESVE TË ASISTENCËS SË TILLË;**

   d. **TË SIGUROJË QË KORNIZA ADEKUATE LIGJORE QË RREGULLON PAGESAT PËR PUNËTORËT E TREPÇËS ËSHTË KRIJUAR DHE PUBLIKUAR;**

   e. **TË NDËRMARRË HAPA TË DUHUR DREJT PAGESËS SË KOMPENSIMIT ADEKUAT ANKUESVE PËR DËMIN E SHKAKTUAR;**

   f. **TË MARRË MASA TË MENJËHERSHME DHE EFEKTIVE PËR T'I ZBATUAR REKOMANDIMET E PANELIT DHE TË INFORMOJË**

ANKUESIT DHE PANELIN RRETH ZHVILLIMEVE TË MËTEJME PËR KËTË RAST.

Andrey Antonov
Zyrtar ekzekutiv

Marek Nowicki
Kryesues

Shtojca

SHKURTESAT DHE AKRONIMET

EULEX - Misioni i Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë
ICCPR - Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike
ECHR - Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut
ECtHR - Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut
GC – Dhoma e Lartë e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut
HRAP - Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut
HRC - Komiteti i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut
IOM – Organizata Ndërkombëtare për Migrim
KAG – Auditori Gjeneral i Kosovës
KCB – Buxheti i Konsoliduar i Kosovës
KFOR - Forca Ndërkombëtare e Sigurisë (zakonisht e njohur si Forca e Kosovës)
KTA - Agjencia Kosovare e Mirëbesimit
MLSW – Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale e Kosovës
OLA - Zyra e Këshilltarit Ligjor
PAK – Agjencia Kosovare e Privatizimit
PISG – Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë
SCSC – Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme në Kosovë për çështjet që ndërlidhen me AKM-në (e trashëguar në vitin 2011 nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme në Kosovë për çështjet që ndërlidhen me AKP-në)
SOE – Ndërmarrje Shoqërore
SRSG - Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm
Kombinati Trepça –Kombinati Xehetaro Metalurgjik Kimik i Plumbit dhe Zinkut Trepça
UN - Kombet e Bashkuara
UNMIK - Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë